

UNIVERZITETI I UEJL

ЈНЕ УННВЕРЗИТЕТ

SEEU UNIVERSITY



FAKULTETI JURIDIK

PRAVEN FAKULTET

FACULTY OF LAW

STUDIMET POSDIPLOMIKE - ÇIKLI I DYTË

TEZA:

KRIMINALITETI I “JAKËS SË BARDHË”

Kandidati:

Valmir Ajrullai

Mentori:

Prof. Besa Arifi

Tetovë, 2018

DEKLARATË

Unë Valmir Ajrullai me përgjegjësi të plotë deklaroj se jam autor origjinal i këtij desertacioni dhe puna e raportuar këtu ka përbërje tërsisht origjinale . Informacini i marrë nga puna e botuar ose e pabotuar e të tjerëve është e cituar në tekst dhe referencat janë dhënë ne listen e burimeve .

Tetovë , 2018

.....

Falënderim

Përgatitja dhe finalizimi i këtij projekti kaq të rëndësishëm në jetën profesionale dhe akademike ka gjetur mbështetjen , përkrahjen dhe dashamirësinë e shumë personave të rëndësishëm në jetën time , të cilët gjej rastin t'i falenderoj përzemërsisht.Mirënjohje dhe falënderim për udhëheqësin shkencorë. Falënderimet më të përzemërta i takojnë familjes sime , në veqanti prindërve të mijë të cilët në rradhë të parë më dhanë edukiminë mbështetjen dhe inkurajimin për të arritur objektivat jetësore .Njëkohësishtë falë përvojës së tyre , ata më dhanë besimë dhe kurajo përgjatë periudhave më të vështira duke dëgjuar ankesat dhe frustrimet mia .

Përmbajtja

Falënderim.....	3
ABSTRAKT.....	6
PJESA E PARË.....	7
1. HYRJE.....	8
A) Qëllimet e hulumtimit	9
c) Hipoteza kryesore.....	10
C)Metodologjia e hulumtimit.....	10
D) Rëndësia e punimit.....	11
PJESA E DYTË.....	13
2. Përkufizimi i krimit ekonomik – financiar.....	14
2.1Historiku i shkurtë i shfaqjes së Krimit Ekonomik - Financiar	18
2.2 Shkaqet e paraqitjes së Krimit Ekonomik – Financiar	21
2.3 Krimi ekonomik – financiar si pengesë e zhvillimit të Republikës së Maqedonisë.	24
2.4 Shkaqet e paraqitjes së kësaj dukurie në vendin tonë	25
2.5 Krimi Ekonomik – Financiar në shtete e tranzicionit	26
2.6 Ekonomia dhe kriminaliteti ekonomik.....	27
2.7Disa nga veçoritë e kriminaliteti ekonomik	29
2.7 Etiologjia e kriminalitetit ekonomik	30
a) Shkaqet e paraqitjes së kriminalitetit ekonomik	30
b).Kushtet të cilat e favorizojnë kriminalitetin ekonomik.....	31
2.10 Baza juridike për luftimin e kriminaliteti ekonomik.....	32
a) Dokumentet ndërkombëtare.....	32
2.11 Krimi Ekonomik në Ligjin e RM-së	37
PJESA E TRETË	39
3.1 Analizë krahasuese midis vendeve të rajonit mbi krimin e organizuar (krimi ekonomik) – Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë	40
3.2 Krimi ekonomik si faktor me ndikim në proceset politike – Rasti i veriut të Kosovës	43
3.3 Krimi ekonomik si fenomen kërcues për sigurinë publike dhe sundimin e rendit dhe Ligjin në Republikën e Kosovës.	44
3.4 Krimi Ekonomik në Maqedoni pengon luftën kundër korrupsionit.....	45

PJESA E KATËRT	46
4.1 Parandalimi i kriminalitetit.....	47
4.2 Shenjat themelore mbi parandalimin e kriminalitetit me vështrim të shkurtër mbi zhvillimin e tij historik	49
4.3 Faktorët që e pamundësojnë zhvillimin e tij	51
4.4 Parimet themelore të parandalimit bashkëkohor të kriminalitetit	54
4.5 Tipologjia e parandalimit të kriminalitetit	55
4.6 Teoritë kriminologjike – mbi parandalimin e kriminalitetit.....	56
4.6.1 Teoria klasike	57
4.6.2 Teoria neoklasike.....	58
4.6.3 Pozitivizmi.....	59
4.6.4 Teoria e dizajnit të mjedisit	60
4.7 Parandalimi situacional i kriminalitetit	61
PJESA E PESTË	62
5.1 Koncepti i hulumtimit dhe rezultatet.....	63
5.2 Metodat e hulumtimit.....	64
5.3 Mostra.....	64
5.4 Analiza	64
5.4.1 Pastrimi i parave.....	64
a) Disa raste të ekzaminuara nga ZIF (SHqipëri) rreth krimit financiar - ekonomik.....	65
b) Republika e Maqedonisë dhe krimi ekonomik	67
PJESA E GJASHTË	69
6.1 Konkluza	70
6.2 Rekomandime.....	71
6.3 Përfundimi	72
6.4 Bibliografia.....	76

ABSTRAKT

Fillimisht në këtë temë do të trajtohen njohuri të përgjithshme mbi kriminalitetin ekonomik në përgjithësi. Në qoftë se i vështrojmë veprat penale në tërësinë e tyre, do të vërejmë se ato i karakterizojnë disa elemente të përbashkëta, sipas të cilave ato renditen në të njëjtën kategori të dukurive shoqërore, e kjo është kriminaliteti. Një prej karakteristikave të tilla është inkriminimi, si shprehje e rrezikshmërisë së tyre shoqërore. Megjithatë, kriminaliteti mbetet si një prej dukurive shumë komplekse dhe heterogjene. Në shumicën e rasteve, midis veprave të ndryshme penale dhe kryesve të tyre ka pak të përbashkëta. Kështu, kriminaliteti ekonomik, deliktet e gjakut, deliktet seksuale dhe veprat penale politike nuk kanë fare ose kanë shumë pak pika të përbashkëta. Kjo dallueshmëri manifestohet madje edhe te veprat penale të të njëjtit lloj. Për të vënë një rend të caktuar në mozaikun e sjelljeve inkriminuese, bëhen ndarje të ndryshme, në lloje dhe grupe. Për këtë arsye, në literature hasen shumë klasifikime të kriminalitetit, të cilat bazohen në kritere të ndryshme. Një prej ndarjeve të shpeshta është ajo që veprat penale i ndan sipas peshës dhe shkallës së rrezikshmërisë shoqërore – në vepra penale të rënda dhe të lehta. Si vepra të rënda penale përmenden: vrasjet, plaçkitjet, vjedhjet e rënda, dhunimet, falsifikimet, mashtrimet etj. Vepra të rënda penale janë: vjedhjet e vogla, prishjet e rendit e qetësisë publike, ofendimet, shpifjet, etj., për të cilat shqiptohen dënime më të lehta. Struktura e kriminalitetit mund të bëhet edhe në bazë të kritereve të tjera, siç janë: natyra e veprave penale, karakteri dhe lloji i objektit të mbrojtur, fushat e jetës shoqërore dhe vlerat që janë sulmuar, elementi moral, kategoria e gjinisë dhe moshës, vendi dhe koha e kryerjes së veprës penale, etj. Pastaj vjen renditja në delikuentë primarë e recidivistë (përsëritës), dhe ndarje të tjera. Në ditët e sotme bëhet ndarja në forma klasike dhe të reja të kriminalitetit. Veprat klasike i sulmojnë të mirat që konsiderohen vlera shoqërore, në kuptimin material ose moral, pak a shumë, në të gjitha sistemet shoqërore. Shpjegimet e mësipërme tregojnë se mund të bëhen klasifikime dhe tipologji të ndryshme të kriminalitetit – më të gjerë ose më të ngushtë, kështu që ai mund të ndahet në bazë të kritereve të ndryshme. Kjo, para së gjithash, varet nga qëllimi, të cilit duhet t'i shërbejë klasifikimi i caktuar. Lidhur me nocionin e kriminalitetit ekonomik ekzistojnë pikëpamje të ndryshme, të cilat ndryshojnë varësisht prej vendit, por ndodh shpesh që edhe në të njëjtin vend ka dallime midis autorëve. Kriminaliteti ekonomik është kategori penale-juridike.

PJESA E PARË

1. HYRJE

Nocioni i kriminalitetit ekonomik nuk është përcaktuar qartë as në teorinë penale-juridike dhe as në praktikën e Bosnjës e Hercegovinës e në vendet e ish-Jugosllavisë, ku pikëpamjet e autorëve pak a shumë dallojnë midis tyre. Një grup thotë se vepra të kriminalitetit ekonomik janë ato sjellje të personave fizikë e juridikë që shkaktojnë rrezik shoqëror dhe dëmtojnë politikat e reja shoqërore e ekonomike; një grup tjetër thotë se vepra penale e kriminalitetit ekonomik është sulm karakteristik në organizimin dhe funksionimin e sistemit ekonomik; një grup i tretë niset nga sulmet inkriminuese në sistemin ekonomik në përgjithësi; ndërsa një grup i katërt konsideron se esenca e veprave penale të kriminalitetit ekonomik ka të bëjë me dëmet që i shkaktohen pronës gjatë kryerjes së aktiviteteve ekonomike. Këto janë të ashtuquajturat shkelje, të cilat nuk janë përfshirë në kriminalitetin si dukuri e përgjithshme, kështu që mund të kuptohet sikur shkeljet janë kategori të shkallës së dytë apo të tretë, nga aspekti i rrezikshmërisë shoqërore. Ka një përcaktim të hershëm për atë që quhet krim i jakave të bardha. Quhet i tillë kur një abuzim, një krim i nëndheshëm me paratë e shtetit, duke bërë kombinacione, me anë të korrupsionit apo transaksioneve, e bëjnë zyrtarë të nivelit të lartë. E thënë me fjalë të tjera, këtë krim të padukshëm e bëjnë ata që rrinë në zyra, që vishen me kostume e kravata firmato e që janë pjesë e serës më të lartë të pushtetit politik, por edhe teknik. Si e tillë në Maqedoni në një farë mënyre është një krim i ri, që në fakt ne na ngjan i vjetër.

Po ashtu do të trajtojmë pjesën : "Krimi me jaka të bardha, a është krim?". **Me gjithë praninë e dispozitave penale për ndëshkimin e veprimtarive që cenojnë konkurrencën, mashtrimin mbi mallrat, dhunën e së drejtës së shoqërive ekonomiko-tregtare dhe butësinë e reagimit shoqëror ndaj tyre, sipas tij shënonte një mohim penal sistematik. Kriminologu amerikan kujtohet, gjithashtu, si ndër të parët që theksoi se deri në çfarë pike është përherë problematik vlerësimi shoqëror i akteve të paligjshme që kryejnë mbajtësit e pushtetit.**

A) Qëllimet e hulumtimit

Qëllimet kryesore të hulumtimit janë të rëndësishme, me anë të qëllimeve kuptojmë synimin cka duhet të arihet, cka dhe si realizohet ky fenomen në Maqedoni. Disa nga qëllimet e domosdoshme janë:

Përshpejtimi i globalizimit ekonomik mbështetur në integrimin e tregjeve financiare globale dhe strategjitë e tregut të lirë e kanë minimizuar rëndësinë e kufijve në mes shteteve, dhe si të tillë kanë hapur dritare të reja për krimin ekonomik. Krimi ekonomik-financiar ka qenë një nga shqetësimet madhore të shoqërive të ndryshme për dekada të tëra. Është emëruar i përbashkëtse krimi ekonomik shkakton humbje të të ardhurave publike, ka një pasqyrë negative mbi shoqërinë në përgjithësi dhe deformon ekonominë kombëtare ose ndërkombëtare si dhe cenon besimin tek sistemi ekonomik. Jam përcaktuar pikërisht për ta trajtuar këtë temë duke u nisur nga fakti se krimet ekonomike-financiare lidhen ngushtë me motivin e përfitimit dhe prodhojnë sasi të mëdha përfitimesh të paligjshme dhe se këto forma të krimit kërcënojnë seriozisht zhvillimin e demokracisë dhe të shtetit të së drejtës, si dhe të drejtat e njeriut, por edhe sigurinë dhe zhvillimin e ardhshëm të shtetit të Maqedonisë. Mendoj se parandalimi dhe dënimi i krimit në përgjithësi dhe i krimit ekonomik-financiar në veçantimbështeten gjerësisht në një njohje të thellë të fenomeneve, në një vullnet politik të qartë dhe të vendosur, në një politikë kombëtare dhe një strategji kundër krimit, gjithnjë në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare si dhe në zbatimin e përpiktë të tyre. Prandaj, pa një njohje të thellë të këtyre fenomeneve, Qeveria dhe organet e tjera të pushtetit do të dështojnë në mënyrë të pashmangshme, në parandalimin dhe luftimin e kësaj forme të krimit.

Po ashtu, mendoj se në këtë kuadër edhe korrupsioni është një ndër instrumentet themelore për influencimin dhe depërtimin tek strukturat politike dhe komerciale dhe si i tillë përbën një shqetësim madhor. Fakti se në Maqedoni është miratuar Ligji kundër Korrupsionit është hap premtues, megjithatë niveli konkret i zbatimit të tij në praktikë si dhe angazhimi pa rezervë i autoriteteve përkatëse në zbatimin e ligjit ende përbën shqetësim. Hulumtimi dhe marrja me këtë problematikë dhe në fund ofrimi i konkluzioneve lidhur me tezat e parashtuara në këtë punim shkencor që lidhen me krimet ekonomiko-financiare, besoj që do të jetë një kontribut i çmueshëm në parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie negative nga organet përkatëse në Maqedoni. Jemi dëshmitar se krimi ekonomik në botë, fatkeqësisht është në zhvillim. Prandaj

miratimi i ligjeve dhe zbatimi i tyre është një nevojë imediate për parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie e cila si rezultat do të ketë në mënyrë të ndjeshme përmirësimin në mbledhjen e të ardhurave, si dhe në anën tjetër zvogëlimin e mundësisë së tregtisë së paligjshme në Maqedoni.

c) Hipoteza kryesore

Duke e ndërlidhur me temën:

- 1. Pagat e ulëta në sektorin publik ndikojnë që në Republikën e Maqedonisë të jetë pjesëmarrëse Kriminaliteti i “jakave të bardha”*
- 2. Dëshira për pasurim të shpejtë të njerëzve është faktor që ndikon në paraqitjen e këtij fenomeni.*
- 3. Kriminaliteti është kategori penale – juridike.*
- 4. Krimi ekonomik financiar është pengesë për zhvillim në vendin tonë.*

C) Metodologjia e hulumtimit

Fenomenet dhe dukuritë e dëmshme shoqërore mund të parandalohen dhe luftohen në mënyrë efikase vetëm nëse më parë hulumtohen e studiohen në mënyrë të gjithanëshme. Thënë ndryshe, shoqëria e organizuar dhe juridikisht e rregulluar, formave të ndryshme të patologjisë shoqërore, siç është kriminaliteti, mund t’iu kundërvihet me ndërmarrjen e masave adekuate preventive e represive, vetëm kur paraprakisht të jenë studiuar shkencërisht dimensionet, vëllimi, trajtat e paraqitjes, rrethanat që i shkaktajnë ato etj. Ky studim është bazuar në hulumtimin e krimit të organizuar pikërisht të kriminaliteti ekonomik (krimi i jakave të bardha).

Metodologjia e ndjekur për realizimin e këtij punimi është:

- Metoda diskriptive- kjo metodë me shërbej për marrjen e mendimeve dhe ideve nga autorë të ndryshëm të cilët kanë çasjen e tyre intelektuale në definimin dhe elaburimin e temës. Unë si hulumtues shkencor hulumtimet e mia do ti bazoj në këto teori:*

- *Metoda historike mua do të më shërbejë si një pasqyrë retrospektive të ndodhive dhe krizave të cilat e kanë përfshirë shtetin tonë nga ana e kriminalitetit të jakave të bardha. Kronologjinë e definimit të krimit të organizuar dhe rëndësinë shoqërore.*
- *Unë nga kjo pasqyrë mund të nxjerr fotografinë reale të situatave ku paraqitet krimi i organizuar (krimi i jakave të bardha)*
- *Metoda e analizës me ndihmën e anketës e cila do të më shërbeje për të analizuar dhe për të kthjellur dokumentet, marrveshjet, strategjitë, të cilët janë hartuar për mbrojtjen e shtetit nga kjo fenomen negativ.*
- *Metoda përshkruese me anë të kësaj metodë paraqesim gjendjen dhe situaten reale në të cilën gjendet Republika e Maqedonisë me mos zbatimin e ligjit kundër korrupsionit. Në këtë studim janë përdorur një sërë materialesh si libra të fushës, shkrime në artikuj shkencor.*

D) Rëndësia e punimit

Punimi është i rëndësishëm së nëpërmjet literaturës vendase dhe asaj të huaj të evidentoj krimin ekonomik dhe krahasimin me rajonet. Ekonomi, si në të kaluarën edhe tani, është cak i veprimeve kriminale .Funksioni i saj kompleks në shoqërin bashkëkohore paraqet tërësinë e veprimeve prodhuese dhe joprodhuese në sferë të produktivitetit, qarkullimit, shpenzimeve dhe shërbimeve.Ekonomia dhe sistemi ekonomik në përgjithësi konsiderohen segmente me rëndësi vitale të jetës shoqërore.I gjithë aktiviteti i institucioneve shtetore, subjekteve ekonomike dhe atyre fizike duhet tu sigurohet mbrojtje efikase juridiko – penale. Duke i pasur parasysh pluralitetin e mendimeve të tericienëve, lidhur me atë se çfarë përfshinë në vete kuptimi i kriminalitetit ekonomik, kemi konsideruar se në përmbajtje të këtij kuptimi bejnë pjesë forma të llojllojshme të sjelljeve (veprimeve dhe mosveprimeve) kriminale të personave juridikë dhe fizikë në sferën e qarkullimit financiar në afarizem, të drejtuar kundër sistemit ekonomik, pavarësisht nga statusi ligjor i pronës e që janë të inkriminuara me kod.

Ligj ose ligje penale si vepra të ndaluara dhe të dëmshme shoqërore. Kriminaliteti ekonomik ka disa veqori të cilat reflektohen në aftësinë e përshtatjes së shpejtë rrethanave shoqërore, fshehtësisë, dimensionet të kriminalitetit të organizuar, tendences së zgjerimit të vazhdueshëm, dëmit të shkaktuar dhe ndikimit në rënjën e moralit shoqëror. Kushtet të cilat e favorizojnë këtë dukuri negative konsiderohen dobësitë në lidhje me organizimin e veprimtarisë ekonomike, mangësitë në kontrollin e brendshëm, lëshimet në inspektime, mbrojtje të pamjaftueshme të pasurisë së personave fizikë dhe asaj shoqërore, politikë të dobët dhe joadekuate kadrovike. Andaj, nëse një shoqëri e cila pretendon që të ketë një ekonomi të tipit perendimor, të integruar në ekonomi të tregut, konkurente me vendet tjera në tregjet ndërkombëtare, detyrimisht duhet që të sigurojë asaj mbrojtje adekuate dhe cilësore juridiko – penale. Kjo, jo vetëm në aspektin strategjik të mbrojtjes formale të ekonomisë por, edhe me aktivite dhe masa të vazhdueshme dhe të zbatueshme në praktikë duke i operacionalizuar me politika preventive dhe represive

PJESA E DYTË

2. Përkufizimi i krimit ekonomik – financiar

Përse njerëzit i bëjnë keq njëri tjetrit”?Kjo është një prej pyetjeve më të rëndësishme që shtrohet para kriminologëve.Por, kjo pyetje, njëherazi, është edhe pikënisja qendrore prej nga është zhvilluar edhe shkenca e kriminologjisë.Megjithatë, orvatja për ta kërkuar përgjigjen në këtë dhe në pyetjet tjera me përmbajtje të ngjashme ka ekzistuar edhe në periudhat shumë më të hershme, para se të paraqiteshin këto disiplina shkencore.Kërkimi i përgjigjes, shpjegimit dhe zgjidhjes efikase të problemeve të kriminalitetit gjatë historisë ka tërhequr në një masë të konsiderueshme vëmendjen e autoriteteve religjioze, shkrimtarëve, krijuesve të veprave artistike dhe filozofëve. Për fat të keq, sot ekziston një numër i madh kriminologësh të cilët e parashtrajnë këtë pyetje në një mënyrë ndryshe. Në të vërtetë, sot, kur gara për pasuri materiale paraqet qëllimin themelor të “filozofisë” së funksionimit, jo vetëm të shumicës së individëve, por edhe të organizatave, e madje edhe shteteve, me ç’rast masa, struktura dhe dinamika e kriminalitetit shënon vlera të papara ndonjëherë, gjithnjë e më aktual bëhet parashtrimi i kësaj pyetjeje në mënyrën: ”Përse njerëzit nuk i bëjnë keq njeri tjetrit ?!”.¹

Interesimi i njerëzve të rëndomtë për çështjen e hulumtimit të shkaqeve të sjelljes delikuede mund të reduktohet në disa fusha themelore.Para së gjithash fjala është për interesimin emocional të njerëzve, sepse pa dyshim se krimi, me të gjitha dimensionet e tij, i nxitë fort ndjenjat si të pjesëmarrësit të ngjarjes kriminale, ashtu edhe të të gjithë atyre që njoftohen për ngjarjen e tillë.Përveç kësaj, kriminaliteti paraqet edhe rrezik për sistemin e caktuar të vlerave etike, juridike dhe vlerave tjera shoqërore. Prandaj, për këtë arsye ky fenomen është edhe një nga sferat qendrore të interesimit shoqëror. Kriminaliteti, sidomos aparati shoqëror për luftimin e tij, e ka edhe çmimin e vet gjë që paraqet edhe një nga fushat e rëndësishme të interesimit shtesë të çdo individapo anëtar të bashkësisë.Intenca për të ardhur lehtë deri tek paraja, është një nga objektivat e rëndësishme që e shtyn një person që në jetën e tij të veprojë ndryshe nga normat e pranuar nga shoqëria.Në rastet kur veprimet përputhen me normat e pranuar nga shoqëria dhe kur ligji i lejon ato, atëherë një gjë e tillë stimulohet në të gjitha anët për të fituar para nga aktivitetet e ligjshme.²

¹ Alisabri Shabani, Muhamed Budimlic, Sarajevë/Prishtinë, 2007, fq.5

² Po aty, fq.6

Në rastet kur aktivitetet janë jashtë normave të pranura nga shoqëria, dhe kur ligji tenton t'i parandalojë ato, atëherë këto aktivitete trajtohen si veprime ilegale dhe kriminale. Ekzistojnë faktorë të ndryshëm motivimi për një person për të bërë këto vepra kriminale. Këta faktorë mund të klasifikohen në mënyra të ndryshme. Tani për tani është e mjaftueshme të themi se faktori kryesor motivues i krimeve nga të cilat një person dëshiron të përfitojë para quhet krim ekonomik-financiar. Kriminaliteti ekonomik, në çfarëdo forme qoftë ai, i ka disa karakteristika të veçanta të cilat në masë të konsideruar dallohen nga ato të kriminalitetit të përgjithshëm. Kriminaliteti ekonomik, në çfarëdo forme qoftë ai, i ka disa karakteristika të veçanta të cilat në masë të konsideruar dallohen nga ato të kriminalitetit të përgjithshëm. Në rend të parë, sipas konstatimit të disa autorëve, sjelljet kriminale të kriminalitetit të përgjithshëm zakonisht janë transparente, me pasojë të dukshme dhe të prekshme në jetën e përditshme. Personat e dëmtuar me krimin e vjedhjes, plaçkitjes apo ndonjë krimi tjetër, pasojat e krimit i hetojnë dhe në të shumtën e rasteve edhe kryerësit e tij i identifikojnë menjëherë. Zakonisht ndaj këtyre kryerësve bëhen kallëzime penale dhe ata në të shumtën e rasteve dalin para gjykatës, ndërkohë me dënime të ndryshme dhe në fund, viktimat në një mënyrë fiton një satisfaksion ose kompensim për vlerat e vjedhura etj. ndërsa, kur është në pyetje kriminaliteti ekonomik, nuk ndodh kështu, ngase këto krime kryhen në mënyrë të fshehtë, vet kryerja esjelljeve kriminale ekonomike nuk shkakton përherë ndërrime të dukshme në jetën e përditshme dhe as pasojat e këtyre krimeve nuk janë të drejtpërdrejta dhe aq transparente. Të dëmtuarit nga këto krime shpeshherë duken si të panjohur dhe abstraktë në shikim të parë. Ndaj këtij kriminaliteti reagohe vetëm mbasi të dal në shesh veprimtaria e tillë kriminale. Nga ana tjetër, veprimi i kryerjes së këtyre krimeve zakonisht zgjatë shumë dhe sa më gjatë të jetë intervali i kryerjes, aq më vështirë është zbulimi i kryerësve, ndërsa dëmet materiale të këtyre krimeve rriten gjithnjë e më tepër.³

Autori i krimit financiar jo vetëm që dëshiron të akumulojë para nga burimet ilegale, por ai njëkohësisht kërcënon rendin ekonomik botëror si dhe i krijon dëm zhvillimit ekonomik nacional. Në shumicën e vendeve ku shfaqen krimet ekonomike financiare dhe sidomos

³ Ragip Halili, Kriminologjia 2005, f.195-20

korupsioni dhe pastrimi i parave kanë ndikim jashtëzakonisht negativ në zhvillimin ekonomiko-shoqëror të atyre vendeve. Krimet ekonomike financiare kontribuojnë në degradimin e normave shoqërore. Ky lloj krimi shkakton kaos dhe çrregullim në shoqëri, duke krijuar hapësira të gjera në mes të atyre që përfitojnë para në mënyrë të mundimshme por të ndërgjegjshme, dhe të atyre që tek paraja vijnë shumë lehtë.

Shumë autorë që merren me këtë problematikë mendojnëse marrësit e ryshfetit si dhe dhënësit e ryshfetit janë armiq të më të mëdhenj të kombeve dhe se ata meritojnë ndëshkimet më të rëndë për veprimet e kryera. Krimi ekonomik ashtu siç përkufizohet në Rekomandimin e Këshillit të Evropës⁴ a qenë një nga shqetësimet madhoretë shoqërive evropiane për dekada të tëra. Rekomandimi, mbështetet në supozimin se krimi ekonomik shkakton humbje të të ardhurave publike, ka një impakt negativ mbi shoqëritë në përgjithësi dhe deformon ekonominë kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe cenon besimin tek sistemi ekonomik. Si përfundim, ai dëmtin demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut si dhe progresin ekonomik dhe shoqëror. Thënë në mënyrë të përgjithshme, krimet e kryera me motiv përfitimi të parasë mund të klasifikohen si krime ekonomike-financiare. Përveç kësaj, ndikimi shoqëror-ekonomik i krimit gjithashtu është marrë në konsideratë për një klasifikim të tillë. Duke pasur parasysh ndikimin shoqëror-ekonomik të krimit, krimet në vijim konsiderohen si krimet më të rënda financiare. Edhe pse realisht ky lloj krimi vështirë zbulohet, jemi dëshmitarë se në kohën moderne është një ndër llojet e krimeve më të pranishme. Mjafton të shfletojmë titujt kryesor nëpër gazeta të përditshme apo edhe të shikojmë emisione të ndryshme përmes mediumeve elektronike dhe të krijohet bindja për një konstatim të tillë. Këtu fjala është posaçërisht, për aferat e ndryshme të korupsionit, pastrimit të parave, transaksioneve të ndryshme përmes bursave, të mashtrimeve, shmangies së tatimeve etj. Të gjitha këto veprime kriminale merren për qëllime të përfitimeve materiale dhe financiare. Pra, ato veprime nuk janë të bazuara në punë dhe aktivitete të ligjshme dhe të ndershme por në keqpërdorime, mashtrime dhe transaksione të dyshimta.

Disa autorë, në kërkimet e tyre mbi këtë formë të kriminalitetit dhe duke u bazuar në rezultatet e anketave të zhvilluara, kanë ardhur në përfundim se delinkuenti ekonomik, kriminel

⁴ Rekomandimi i Këshillit të Evropës R (81) 12 i vitit 1981, mbi Krimin Ekonomik (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 25 qershor 1981) rendit 16 vepra penale specifike dhe jo specifike të cilat konsiderohen krime ekonomike

i disa formave të krimeve ekonomike si p.sh: mashtrimeve, transaksioneve të ndryshme nga të cilat nxjerr përfitime të mëdha, jo vetëm që nuk gjykohet, por në një mënyrë, gëzon njëfarë simpatie, bile në disa raste bëhet edhe njëfarë lloji heroi i mjedisit të caktuar, sepse ka treguar mjeshtëri dhe aftësi të veçanta të mashtrojë shtetin apo firmën tjetër dhe të pasurohet pa djersë.⁵

Në qoftë se i vështrojmë veprat penale në tërësinë e tyre, do të vërejmë se ato i karakterizojnë disa elemente të përbashkëta, sipas të cilave ato renditen në të njëjtën kategori të dukurive shoqërore, e kjo është kriminaliteti. Një prej karakteristikave të tilla është inkriminimi, si shprehje e rrezikshmërisë së tyre shoqërore. Megjithatë, kriminaliteti mbetet si një prej dukurive shumë komplekse dhe heterogjene. Në shumicën e rasteve, midis veprave të ndryshme penale dhe kryesve të tyre ka pak të përbashkëta. Kështu, kriminaliteti ekonomik, deliktet e gjakut, deliktet seksuale dhe veprat penale politike nuk kanë fare ose kanë shumë pak pika të përbashkëta. Kjo dallueshmëri manifestohet madje edhe te veprat penale të të njëjtit lloj. Për të vënë një rend të caktuar në mozaikun e sjelljeve inkriminuese, bëhen ndarje të ndryshme, në lloje dhe grupe. Për këtë arsye, në literaturë hasen shumë klasifikime të kriminalitetit, të cilat bazohen në kritere të ndryshme. Një prej ndarjeve të shpeshta është ajo që veprat penale i ndan sipas peshës dhe shkallës së rrezikshmërisë shoqërore – në vepra penale të rënda dhe të lehta. Si vepra të rënda penale përmenden: vrasjet, plaçkitjet, vjedhjet e rënda, dhunimet, falsifikimet, mashtrimet etj. Vepra të rënda penale janë: vjedhjet e vogla, prishjet e rendit e qetësisë publike, ofendimet, shpifjet, etj., për të cilat shqiptohen dënime më të lehta. Struktura e kriminalitetit mund të bëhet edhe në bazë të kritereve të tjera, siç janë: natyra e veprave penale, karakteri dhe lloji i objektit të mbrojtur, fushat e jetës shoqërore dhe vlerat që janë sulmuar, elementi moral, kategoria e gjinisë dhe moshës, vendi dhe koha e kryerjes së veprës penale, etj.⁶

Pastaj vjen renditja në delikuentë primarë e recidivistë (përsëritës), dhe ndarje të tjera. Në ditët e sotme bëhet ndarja në forma klasike dhe të reja të kriminalitetit. Veprat klasike i sulmojnë të mirat që konsiderohen vlera shoqërore, në kuptimin material ose moral, pakashumë, në të gjitha sistemet shoqërore. Shpjegimet e mësipërme tregojnë se mund të bëhen klasifikime dhe tipologji të ndryshme të kriminalitetit – më të gjerë ose më të ngushtë, kështu që ai mund të ndahet në bazë të kritereve të ndryshme. Kjo, para së gjithash, varet nga qëllimi, të cilit duhet t'i shërbejë

⁵ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2005

⁶ Dr. Mersida Suçeska, Bazat e kriminalitetit ekonomik, Prishtinë, FSK/S – 07/06, 2006, fq.12

klasifikimi i caktuar. Më parë ndarjet janë bërë më shumë sipas klasave, ndërsa tash bëhet sipas tipave. Meqenëse tipi formohet në bazë të tërësisë së më shumë shenjave korelative, një tipi duhet t'i jepen ato forma të kriminalitetit që i karakterizon një numër i caktuarshenjash, të cilat tregojnë veprat penale dhe kryesit e tyre. Këta janë të ashtuquajturit „tipa ideal“. Përveç këtyre ekzistojnë edhe tipat e përziera“, si edhe format e sjelljes kriminale, të cilat nuk i përkasin asnjë tipi. Siç duket, bëhet fjalë për një çështje të rëndësishme dhe komplekse, e cila meriton analizë dhe studim të veçantë, në të cilën nuk mund të ndalemi në këtë rast. Për këtë arsye, në shqyrtimin tonë të mëtejshëm, nuk do të hyjmë në analizën e tipologjisë së kriminalitetit, por do të përqendrohemi vetëm në kriminalitetin ekonomik.⁷

2.1 Historiku i shkurtë i shfaqjes së Krimit Ekonomik - Financiar

Mashtrimi-si art i dinakërisë së qëllimshme për përfitime të paligjshme-është i vjetër sa vet historia. Ligjet kundër atyre veprimeve që tani quhen krime ekonomiko-financiare kanë ekzistuar që nga kohët e lashta. Zakonisht ato ligje janë vendosur si kundërpërgjigje ndaj ngjarjeve në të cilat është vërejtur se diçka ka ndodhur që ka sfiduar senzibilitetin moral të shoqërisë. Për shembull: grumbullimi i drithërave me qëllim të zvogëlimit të furnizimit e pastaj për të përfituar shuma të mëdha. Grumbullimet e tilla kanë mundur ta hedhin popullin në protesta dhe në rrëzime të qeverive të cilat nuk kanë bërë asgjë për të garantuar një çmim të arsyeshëm për furnizimin e popullatës me gjërat më elementare ushqimore. Portermi krim ekonomiko-financiar (krimi i jakave të bardha) daton nga viti 1939. Profesor Edëin Sutherland (Sociolog) ishte i pari që ka shpikur këtë term, dhe ka vënë hipotezën se kriminelët e “jakave të bardha” kanë karakteristika dhe motive të tjera krahasuar me kriminelët tipik të rrugës. Aika prezantuar këtë teori duke iu drejtuar Shoqërisë Sociologjike Amerikane (American Sociological Society) në përpjekje të studimit të dy fushave, krimin dhe shoqërinë e lartë, të cilat më parë nuk kanë pasur korrelacion empirik. Ai e definoi idenë e tij si “krim i kryer nga një person i respektuar dheme statutë lartë social gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.”⁸

⁷ Dr. Mersida Suçeska, Bazat e kriminalitetit ekonomik, Prishtinë, FSK/S – 07/06, 2006, fq.12

⁸ ëëë.hg.org/ëhite-collar-crime.html

Sutherland kishte shkruar se në këtë kohë , "më pak se dy për qind e personave të burgosur gjatë një viti i takonin klasës së lartë." Qëllimi i tij ishte të vërtetojë lidhjen midis parasë, statusit social dhe gjasave për të shkuar në burg për krimin e "jakave të bardha" krahasuar me krimin më të dukshëm dhe më tipik. Megjithëse përqindja sot është pak më e lartë, numrat akoma tregojnë se shumica e madhe e atyre që janë në burg, janë të varfrit, kriminelët "jakëblu", përkundër përpjekjeve për të marr masa energjike ndaj krimit të korporatave. Sutherland punoi shumë për të ndarë dhe definuar dallimet e krimeve të rrugës të jakave-blu si vrasje, zjarrvënie, vjedhje me thyerje, vjedhje, sulm, dhunim, dhe vandalizëm për të cilat shpesh faji u lihet faktorëve psikologjik, asocial dhe strukturorë. Përkundër kësaj, kriminelët jakë-bardhë janë oportunistët, të cilët me kohë kanë mësuar se mund të përfitojnë nga rrethanat e tyre për të akumuluar përfitime ekonomike financiare. Ata janë të arsimuar, inteligjentë, të pasur, individë të besuar që janë mjaft të kualifikuar për të gjetur një punë e cila atyre u mundëson qasje të pa monitoruar në shuma të mëdha parash. Shumë nga ta gjithashtu shfrytëzojnë inteligjencën e tyre për t'i mashtruar viktimat e tyre për të besuar në kredencialet e tyre. Shumë nga ta nuk fillojnë si kriminelë, dhe në shumë raste ata kurrë nuk e konsiderojnë veten të tillë. Madje Sutherland nuk ishte i pari që është marr me devijimin e të pasurve, të fuqishmëve dhe të privilegjuarve. Duket se para tij Edëard A. Ross ishte ai që kishte raportuar mbi mëkatet e "Kriminoidit" tani artikull klasik në "The Atlantic Monthly" në vitin 1907: "Me këtë ne tregojmë ata që prosperojnë me anë të praktikave tepër të liga që akoma nuk iu kanë nënshtruar ndalimit efektiv të opinionit publik. Në të vërtetë ata shpesh janë fajtorë në sytë e ligjit, por meqë që nuk janë fajtorë në sytë e publikut dhe në sytë e vetë atyre, botëkuptimi i tyre shpirtëror nuk është ai i kriminelit."⁹

Albert Morris ishte i pari që shqyrtoi abuzimet e "kriminelëve të botës së sipërme" në formë të një libri. Në trajtimin e tij mbi Kriminologjinë (1935) ai definoi "kriminelët e klasës së lartë " si: "atë grup të numërt por kurrë të definuar qartë të kriminelëve pozita sociale, inteligjenca dhe teknika kriminale e të cilëve u lejon atyre të lëvizin në mesin e bashkë qytetarëve të tyre virtualisht imun për tu njohur dhe ndjekur si kriminelë". Lidhje e përbashkët intelektuale mes Ross-it, Morris-it dhe Sutherland-it ishte imuniteti i një grupi kriminelësh nga procesi juridik për shkak të statusit të tyre social, ekonomik dhe politik; temë kjo të cilën Sutherland-i e kapitalizoi në mbledhjen e mbështetjes publike për idetë e reja të tij. Idhur me nocionin e kriminalitetit

⁹ Ross Edëard A, Sin and Society, 1907

ekonomik ekzistojnë pikëpamje të ndryshme, të cilat ndryshojnë varësisht prej vendit, por ndodh shpesh që edhe në të njëjtin vend ka dallime midis autorëve. Kriminaliteti ekonomik është kategori penale-juridike. Nocioni i kriminalitetit ekonomik nuk është përcaktuar qartë as në teorinë penale-juridike dhe as në praktikën e Bosnjës e Hercegovinës e në vendet e ish-Jugosllavisë, ku pikëpamjet e autorëve pakashumë dallojnë midis tyre. Një grup thotë se vepra të kriminalitetit ekonomik janë ato sjellje të personave fizikë e juridikë që shkaktojnë rrezik shoqëror dhe dëmtojnë politikat e reja shoqërore e ekonomike; një grup tjetër thotë se vepra penale e kriminalitetit ekonomik është sulm karakteristik në organizimin dhe funksionimin e sistemit ekonomik; një grup i tretë niset nga sulmet inkriminuese në sistemin ekonomik në përgjithësi; ndërsa një grup i katërt konsideron se esenca e veprave penale të kriminalitetit ekonomik ka të bëjë me dëmet që i shkaktohen pronës gjatë kryerjes së aktiviteteve ekonomike.

Më e përhapur është pikëpamja që bazohet në klasifikimin juridik të së drejtës penale materiale, e cila i konsideron kriminalitetit ekonomik ato veprimtari me të cilat sulmohet sistemi ekonomik nacional, të cilat janë inkriminuar me dispozitat e Kodit Penal (në tekstin e mëtejme KP). Kjo pikëpamje bazohet në nomenklaturën e KP, ndërsa këto vepra penale evidentohen në statistikën zyrtare. Kjo pikëpamje nuk është plotësisht e qëndrueshme, jo vetëm për shkak se në kapitujt e KP nuk janë përfshirë shumë inkriminime që mund të konsiderohen vepra penale të kriminalitetit ekonomik, por edhe për shkak se ajo nuk kryejnë shoqëritë ekonomike gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tyre ekonomike. Këto janë të ashtuquajturat shkelje, të cilat nuk janë përfshirë në kriminalitetin si dukuri e përgjithshme, kështu që mund të kuptohet sikur shkeljet janë kategori të shkallës së dytë apo të tretë, nga aspekti i rrezikshmërisë shoqërore.¹⁰

¹⁰ Dr. Mersida Sućeska, Bazat e kriminalitetit ekonomik, Prishtinë, FSK/S – 07/06, 2006, fq.12

2.2 Shkaqet e paraqitjes së Krimit Ekonomik – Financiar

Kriminalitetit ekonomik nuk është fenomen i ri. Ai shfaqet edhe ne te gjitha rregullimet shoqërore.¹¹Nuk ekziston ndonjë definicion i pranuar në tërësi i shkaqeve të paraqitjes së krimit ekonomik, dhe është e pamundur numërimi i lehtë i definicioneve, teorive dhe veprave të ndryshme që përfshihen në këtë kategori.

Ne po fokusohemi në punën teorike që hulumton tri aspektet e krimit ekonomik: motivimet e kryesit të veprës, përfitimet nga kryerja e veprës dhe proceset ekonomike. Botëkuptimi i parë u referohet krimeve ekonomike si veprime ilegale në të cilat motivimi kryesor i kryesve të veprave të tilla duket të jetë përfitimi ekonomik. Këtu, krimi ekonomik trajtohet si çdo vepër në të cilën individët apo grupet e individëve veprojnë në mënyrë ilegale me qëllim të përfitimit financiar (plaçkitja, shitja e drogës, evazioni fiskal, krimi kompjuterik dhe abuzimi me ndihma ekonomike). Edhe pse konceptualisht sfiduese ky botëkuptim ka disa mangësi. Për shembull: ky presupozon se motivimet e kryesve të veprave janë të dukshme dhe të njohura nga vet akti kriminal. Edhe pse në shikim të parë, motivi për plaçkitje mund të jetë si dëshirë për pasurim, motivi kryesor i kryesve të veprave mund të jetë tjetër (urrejtja racore apo fetare etj.). Disa krime kanë shumë motive dhe përfitimi ekonomik mund të jetë qëllim sekondar. Për më tepër, vet kryesit e veprave nuk janë gjithëherë të vetëdijshëm për motivet e tyre dhe mund të mos jenë në gjendje të bëjnë dallimin mes arsyeve që mbështesin veprimet e tyre dhe arsyetimet që i pasojnë. Botëkuptimi i dytë, iu shmanget vështirësive që lidhen me përpjekjen për të përfshirë motivet dhe fokusohet në veprimet ilegale të cilat me sukses u sigurojnë kryesve një përfitim ekonomik. Sidoqoftë, përjashtimi i krimeve në tentativë, analiza kufizon të kuptuarit tonë; veprat e kryera në mënyrë të suksesshme mund të dallojnë në mënyrë ekstreme nga ato që kanë dështuar. Viktimat tipike përfshijnë individët, grupet apo organizatat kundër të cilave është drejtuar veprimi, por një grup shumë më i gjerë i viktimave kanë mundur të ndikoheshin në mënyrë indirekt nga krimet e tilla. Kjo ndodh në rastet kur veprimi kriminal, minon efektivitetin komercial të praktikave normative të biznesit dhe pasojat negative tejkalojnë ato për të cilat është menduar dëmtimi i drejtpërdrejt, për shembull: hakerat kompjuterik, transaksionet në tregun e stokeve etj.

¹¹ Po aty, fq.14

Ky definicion i dedikohet pasqyrimin të zakonshëm në kriminologji duke injoruar apo nënvlerësuar çështjet e viktimave. Sidoqoftë, është shumë i ngushtë në disa aspekte dhe shumë i gjerë në disa tjera, për shembull: ai përjashton krimet “pa viktima” që kanë implikime ekonomike p.sh. prostitucioni, dhe përfshin çdo vepër ku viktimat përjetojnë një çmim, p.sh: sulm që rezulton me shpenzime mjekësore apo humbje pagash. Botëkuptimi i tretë konsiston në atë se proceset që qojnë në sjellje kriminale janë të njëjta si ato që udhëheqin sjelljen e konsumatorit në treg. Kjo qasje shpjegon shumicën e punës teorike mbi krimet të ofruara nga ekonomistët që nga vitet e fundit të viteve të 60 –ta. Gary Stanley Becker (lindur më 2 dhjetor 1930) ekonomist amerikan dhe fitues i çmimit Nobel në Ekonomi në vitin 1992, paraqet qasjen e tij ndaj krimit ekonomik ecila ndryshon nga qasjet e gjertanishme mbi krimin.¹²

Interesimi i Becker-it në kriminologji ka lindur kur ai një ditë ishte për ngut. Atij iu është dashur të vejë në baraspeshë çmimin dhe përfitimin e parkimit ilegal. Pasi kishte kalkuluar shpejtë e shpejtë e të zënit dhe dënimin e mundshëm, Becker-i në mënyrë racionale ishte përcaktuar për krimin.¹³

Becker i kishte marr me mend se edhe kriminelët tjerë marrin vendime të tilla racionale. Sidoqoftë, një premise e tillë ishte kundër mendimit konvencional se krimi ishte rezultat i sëmundjes mendore dhe nevojë sociale.¹⁴

Gjersa, Becker-i ishte në dijeni se shumë njerëz veprojnë sipas një morali dhe etike të lartë e cila i parandalon për të bërë krime, kriminelët në mënyrë racionale shohin se përfitimet nga krimet që i bëjnë tejkalojnë çmimin që duhet paguar për to siç është mundësia e kapjes, e shpalljes fajtor, e dënimit, si dhe mundësitë e tyre aktuale. Nga perspektiva e politikës publike, meqë shpenzimet e rritjes së gjobës janë marginale në krahasim me shpenzimet e ngritjes së nivelit të mbikëqyrjes, mund të konkludohet se politika më e mirë është të ngritët në maksimum gjoba dhe të ulet në minimum mbikëqyrja. Sidoqoftë, një konkludim i tillë ka kufizimet e tij. Një nga dallimet kryesore në mes të kësaj teorie dhe teorisë së zgjedhjes racionale të Jeremy Bentham, e cila ishte lënë pas dore në kriminologji, është se nëse Bentham konsideronte se është e mundur që krimi të anulohet plotësisht, teoria e Becker-it konsideron se shoqëria nuk mund ta zhduk krimin nën nivelin e caktuar. Për shembull, nëse vidhen 25% e produkteve të

¹² Gary Becker, Crime and Punishment, 1968

¹³ Po aty.

¹⁴ Po aty.

supermarketit, atëherë do të ishte shumë lehtë që të reduktohet kjo në 15%, do të ishte deri diku e lehtë që kjo të zvogëlohet në 5%, do të ishte vështirë që kjo të zvogëlohet nën 3% dhe do të ishte pothuajse e pamundur që kjo të reduktohet në zero (çmimi që do të duhej të paguante supermarketi, për mbikëqyrje etj., do të tejkalonte përfitimet). Ai ka filluar të mendojë për krimin në vitin 1960, pasi që me veturë ishte duke shkuar në Columbia University për ta mbajtur një provim me gojë të një studenti në temën “Teori Ekonomike”. Ishte vonuar dhe i është dashur që shpejt të vendosi a ta parkojë veturën në ndonjë vend parkim apo të rrezikojë që të marr tiketë duke parkuar veturën në mënyrë ilegale në rrugë.

Aikalkuloi gjasat për të marr tiketë, madhësinë e gjobës, dhe çmimin e parkimit në vend parkim të rregullt. Vendos se e vlen të rrezikojë e ta parkojë në rrugë (nukmori tiketë). Gjersa po ecte disa blloqe drejt dhomës së provimit, i shkoi në mendje se edhe autoritet e qytetit me siguri kanë bërë analiza të ngjashme. Frekuenca e inspektimit të veturave të parkuara dhe lartësia e dënimit për shkelësit e ligjit do të duhej të varej nga konstatimet e tyre mbështetur në llojin e kalkulimit që shkelësit e mundshëm të ligjit do ta bënin sikur edhe ai. Natyrisht që pyetja e parë tij që i bëri studentit të pafat ishte të flas për sjelljen optimale të shkelësit të ligjit sidhe të policit, gjë që se kishte bërë më parë. Në vitet 1950-a dhe 1960-a, diskutimet e intelektualëve mbi krimin dominoheshin nga pikëpamja se sjellja kriminale shkaktohej nga sëmundja mendore dhe nga shtypja sociale, dhe se kriminelët ishin “viktima” të pa fuqishme. Një libër i shkruar nga një psikiatër i njohur titullohej “Krimi i Dënimit” (shiko Menninger [1966]). Pikëpamjet e tilla filluan të kenë ndikim të madh në politikën sociale, me që ligjet ndërroheshin për të rritur të drejtat e kriminelit. Këto ndryshime zvogëluan frikën dhe dënimet e kriminelëve dhe jepnin më pak mbrojtje për popullatën që i përmbahej ligjit. Ai nuk ishte ithtar i supozimeve se kriminelët kanë motive radikalisht të ndryshme nga të gjithë njerëzit e tjerë.

Përkundrazi, ai hulumtojë implikimet teorike dhe praktike të supozimit se sjellja kriminale është racionale (shiko veprën Pioneer të Bentham [1931] dhe Beccaria [1986]), por prapë “racionaliteti” nuk implikon medoemos materializmin e ngushtë. Shumë njerëz të shtyrë nga pikëpamjet morale dhe etike nuk bëjnë krime madje edhe kur këto janë profitabile dhe nuk ka rrezik për tu zbuluar. Sidoqoftë, policia dhe burgjet do të ishin të panevojshme po të mbizotëronin gjithmonë idetë e tilla. Racionaliteti lë të kuptohet se disa individ bëhen kriminel për shkak të përfitimeve financiare nga krimi krahasuar me punën legale, duke pasur parasysh gjasat e

inspektimit dhe dënimit, dhe lartësinë e dënimit. Numri i krimeve nuk përcaktohet vetëm nga racionaliteti dhe preferencat e kriminelëve të mundshëm por gjithashtu edhe nga rrethi ekonomik dhe shoqëror i krijuar nga qëndrimet publike, duke përfshirë shpenzimet e policisë.¹⁵

Dënimet për krimet të ndryshme, dhe mundësitë për punësim, shkollim, dhe programe trajnuese. Thënë shkurt, lloji i punëve legale të mundshme si dhe ligji, rendi, dhe dënimi janë pjesë përbërëse e qasjes ekonomike ndaj kriminit.

2.3 Krimi ekonomik – finaciari si pengesë e zhvillimit të Republikës së Maqedonisë.

Kriminaliteti ekonomik nuk është fenomen i ri. Ai shfaqet edhe në të gjitha rregullimet shoqërore. Dihet se edhe në shoqëritë borgjeze inkriminohen disa veprimtari nga fusha e ekonomisë dhe marrëdhënieve ekonomike, për të mbrojtur disa forma dhe marrëdhënie pronësore: private – kapitaliste, shtetërore – kapitaliste, etj. Por, në qoftë se, gjatë përcaktimit të karakterit të kriminalitetit nisemi nga aspekti juridik, nuk mund të vërehen gjithmonë tiparet dhe dallimet e rëndësishme, sipas të cilave dallon varësisht nga shoqëritë. Në të gjitha rastet, këtu bëhet fjalë për inkriminime me normat pozitive, të cilat e mbrojnë pasurinë apo formën e caktuar shoqërore të saj, formulimet juridike të së cilës mund të jenë shumë të ngjashme, madje edhe të njëjta. Në këtë mënyrë është e pamundur të vërehet çfarëdo dallimi, sepse nja qasje e tillë, e cila bazohet në formulë juridike, nuk i kushtohet rëndësi të mjaftueshme karakterit të marrëdhënieve pronësore, të cilat janë të mbrojtura me sistemin normativ pozitiv. Kriminaliteti i veprimtarisë ekonomike është një formë e veçantë e kriminalitetit, e cila ka për qëllim përfitimin material ose të mira të tjera, pavarësisht prej formës dhe vlerës së tyre. Tipare kryesore të këtij kriminaliteti janë «shifrat e errëta», dinamika dhe përshtatja me të gjitha ndryshimet ekonomike e normative. Veprat penale kryhen në dëm të personave juridikë dhe fizikë.¹⁶

¹⁵ R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2005

¹⁶ S. Pihler, Drejt konceptit bashkëkohor të kriminalitetit ekonomik, Problemet aktuale të shkatërrimit të kriminalitetit, Instituti për hulumtime sociologjike dhe kriminologjike, Beograd, 1993, f.35-38 Leksikoni kriminologjik

2.4 Shkaqet e paraqitjes së kësaj dukurie në vendin tonë

Faktorët kryesorë të paraqitjes së kësaj dukurie në Maqedoni, së paku në bazë të sondazheve të gjertanishme të opinionit dhe hulumtimeve të ndryshme që janë bërë kanë të bëjnë kryesisht me:

-Pagat e ulëta në sektorin publik;

-Dëshira për pasurim të shpejtë të njerëzve;

-Kriza morale;

-Mos efikasiteti i sistemit gjyqësor;¹⁷

-Legjislacioni i pakompletuar;

-Mungesa e kuadrove me përvoja për këtë lëmi;

-Prezenca e madhe e bizneseve vendore dhe ndërkombëtare;

Është shumë e natyrshme se faktorët kryesor që kanë ndikuar në shfaqjen, shtrirjen dhe zhvillimin e krimit ekonomik - financiar, gjenezën kanë nga sistemi i kaluar socialist, nga papunësia e madhe që mbretëron, varfëria e popullatës, periudha transite e cila ende po vazhdon etj. Nëse vështrohet nga këndi social-ekonomik, mund të thuhet se krimi ekonomik në Maqedoni nganjëherë mund të jetë çështje e mbijetesës, nganjëherë shërben për të përmirësuar gjendjen materiale të individëve, të cilët janë duke zhvilluar dominimin e tyre në kushtet kur statusi i Maqedonisë ende nuk është i definuar, apo së fundi edhe mund të jetë si rezultatse të ardhurat e popullatës në Maqedoni janë shumë të ulëta.

Nga ana tjetër, nuk ekziston qasje e harmonizuar për parandalim dhe pengimin e krimit ekonomik-financiar, pushtet-mbajtësit ende nuk gëzojnë nivel të kënaqshëm të mirëbesimit tek publiku, shoqëria civile ende është në fazën e zhvillimit të saj, vetëdija e qytetarëve për drejtat dhe obligimet e tyre është në nivel shumë të ulët, roli i medieve është ende vogël në sensibilizimin e publikut për pasojat që shkaktojnë krimet etj. Në përmasat e krimit ekonomik-financiar, padyshim ndikon edhe mospërshtatja me ekonominë e tregut si dhe dëshira për pasurim të shpejtë dhe me rrezik më të vogël, të cilat paraqesin motivin për këtë veprimtari të fshehtë, pra, në thelb, bëhet fjalë për faktorë të natyrës ekonomike.

¹⁷ Dr. Mersida Sucëska, Bazat e Kriminalitetit Ekonomik, Prishtinë 2006

Përveç faktorëve ekonomikë, disa teoricienë si shkaktarë të paraqitjes së krimit ekonomik konsiderojnë edhe faktorët psikologjikë, si për shembull: humbjen e besimit tek shteti dhe masat ekonomike të tij, mentalitetin e popullit dhe mospajtimin e tij me objektivat dhe masat e politikës ekonomike, praninë e shkallës së lartë të rrezikut në aktivitete afariste etj.¹⁸

2.5 Krimi Ekonomik – Financiar në shtete e tranzicionit

Përsheptimi i globalizimit ekonomik mbështetur në integrimin e tregjeve financiare globale dhe strategjitë e tregut të lirë e kanë minimizuar rëndësinë e kufijve në mes shteteve, dhe si të tillë kanë hapur dritare të reja për krimin ekonomik. Krimi ekonomik-financiar ka qenë një nga shqetësimet madhore të shoqërive të ndryshme për dekada të tëra. Është emëruar i përbashkëtse krimi ekonomik shkakton humbje të të ardhurave publike, ka një pasqyrë negative mbi shoqërinë në përgjithësi dhe deformon ekonominë kombëtare ose ndërkombëtare si dhe cenon besimin tek sistemi ekonomik. Jam përcaktuar pikërisht për ta trajtuar këtë temë duke u nisur nga fakti se krimet ekonomike-financiare lidhen ngushtë me motivin e përfitimit dhe prodhojnë sasi të mëdha përfitimesh të paligjshme dhe se këto forma të krimit kërcënojnë seriozisht zhvillimin e demokracisë dhe të shtetit të së drejtës, si dhe të drejtat e njeriut, por edhe sigurinë dhe zhvillimin e ardhshëm të shtetit të Maqedonisë.

Mendoj se parandalimi dhe dënimi i krimit në përgjithësi dhe i krimit ekonomik-financiar në veçantëmbështeten gjerësisht në një njohje të thellë të fenomeneve, në një vullnet politik të qartë dhe të vendosur, në një politikë kombëtare dhe një strategji kundër krimit, gjithnjë në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare si dhe në zbatimin e përpiktë të tyre. Prandaj, pa një njohje të thellë të këtyre fenomeneve, Qeveria dhe organet e tjera të pushtetit do të dështojnë në mënyrë të pashmangshme, në parandalimin dhe luftimin e kësaj forme të krimit. Është dëshmitar se krimi ekonomik në botë, fatkeqësisht është në zhvillim.¹⁹

¹⁸ D. Modly, Leksiokoni kriminalistik, FSHK, Sarejevë, 1998, f. 149

¹⁹ Ragip Halili, Kriminologjia 2005, f.195-205

Prandaj miratimi i ligjeve dhe zbatimi i tyre është një nevojë imediate për parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie e cila si rezultat do të ketë në mënyrë të ndjeshme përmirësimin në mbledhjen e të ardhurave, si dhe në anën tjetër zvogëlimin e mundësisë së tregtisë së paligjshme në Maqedoni. Po ashtu, mendoj se në këtë kuadër edhe korrupsioni është një ndër instrumentet themelore për influencimin dhe depërtimin tek strukturat politike dhe komerciale dhe si i tillë përbën një shqetësim madhor. Fakti se në Maqedoni është miratuar Ligji kundër Korrupsionit është hap premtues, megjithatë niveli konkret i zbatimit të tij në praktikë si dhe angazhimi pa rezervë i autoriteteve përkatëse në zbatimin e ligjit ende përbën shqetësim. Hulumtimi dhe marrja me këtë problematikë dhe në fund ofrimi i konkluzioneve lidhur me tezat e parashtruara në këtë punim shkencor që lidhen me krimet ekonomiko-financiare, besoj që do të jetë një kontribut i çmueshëm në parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie negative nga organet përkatëse në Maqedoni.²⁰

2.6 Ekonomia dhe kriminaliteti ekonomik

Fenomenet dhe dukuritë e dëmshme shoqërore mund të parandalohen dhe luftohen në mënyrë efikase vetëm nëse më parë hulumtohen e studiohen në mënyrë të gjithanëshme. Thënë ndryshe, shoqëria e organizuar dhe juridikisht e rregulluar, formave të ndryshme të patologjisë shoqërore, siç është kriminaliteti, mund t'iu kundërvihet me ndërmarrjen e masave adekuate preventive e represive, vetëm kur paraprakisht të jenë studiuar shkencërisht dimensionet, vëllimi, trajtat e paraqitjes, rrethanat që i shkaktajnë ato etj. Ekonomia dhe funksioni i saj në një vend, posaqërisht në botën bashkëkohor, paraqet tërësinë e veprimtarive prodhuese e joprodhuese në sferën e produktivitetit material, qarkullimit, shpenzimeve dhe shërbime. Ekonomia dhe sistemi ekonomik i një vendi janë segmente me rëndësi vitale të jetës shoqërore. Bazuar në rëndësinë, që ka ekonomia për mirëqenjen shoqërore, shteti angazhohet që të krijoj politikë ekonomike e cila i përshtatet nevojave dhe interesave shoqërore. Paralelisht me politikën ekonomike, nxjerren edhe

²⁰ Ragip Halili, Kriminologjia 2005, f.195-205

norma juridiko-penale, që parashohin masa ndëshkuese për veprime të caktuara më të cilat rrezikohën mardhënjët ekzistuese në ekonomin e një vendi.²¹

Rëndësia e madhe e ekonomisë për shoqërinë, vazhdimisht ka kushtëzuar nevojën për rregullimin penalo-juridike të saj, duke i nxitë kështu ndryshimeve pozitive në këtë lëmi. Konceptonet liberaliste të zhvillimeve shoqërore-ekonomike të ndërtuara mbi bazën e lirisë së pakufizuar, nuk mundën të qendrojnë gjatë. Zhvillimet e shpejta të viteteve të 30-ta të shek XX, në lëmin e teknologjisë, koncentrimit të kapitalit në disa subjekte të caktuara, konkurenca jolojale etj, patën si rezultat paraqitjen qregullimeve shoqërore të karakterizuara më kriza të mëdha ekonomike, sociale, juridike etj, deri te zhvillimi i luftërave të armatosura. Gjendja e tillë imponoj nevojën e intervenimit të shtetit në rregullimin e marrdhënjëve të reja ekonomike, si në planin nacional, po ashtu edhe në atë ndërkombëtarë. Për krijimin e këtyre marrdhënjëve të reja shoqërore-ekonomike, shtetet çdo herë e më shumë intervenonin me norma juridike që ekonomia dhe sistemi ekonomikë të mbrohet në mënyrë efikase.²²

Të gjitha shtetet, pavarisist nga rregullimi i tyre shoqëro-ekonomik, dhe qendrimet e tyre se cilat forma të sjelljeve kundër ekonomisë duhet inkriminuar në legjislacionet penale, bazuar në interesin e tyre për rregullimin dhe funksionimin e sistemit ekonomik, rregullojnë mbrojtjen juridiko-penale të marrdhënjëve ekonomike, dhe shpesh veprat penale kundër ekonomisë i rëndisin si grupe të veçanta të veprave në legjislacionin penal.²³

Shtetet që kanë ekonomi të zhvilluar, njëkohësisht edhe vendet që janë në faza të ndryshme të tranzicionit, angazhohën që ekonomitë nacionale të funksionojnë dhe sipas parimeve të reja globaliste dhe integritimeve ekonomiko-politike multinacionale.²⁴ Sidoqoftë, funksionimi normal i sistemit ekonomik dhe mbrojtja e tij nga kriminaliteti si dukuri specifike shoqërore negative, imponon sjelljen e legjislacionit adekuat në fushën juridiko-penale, fushë kjo ku zakonisht e rregullon e drejta penale ekonomike.

²¹ N.Serzentiq e A.Stajiq “E d rehta Penale” Pjesa e posaçme, Prishtinë 1981, fq.181

²² Komentar Kriv ičnog Zakona SFRJ “Savremena Ad min istracija” Beograd, 1982, fq.530

²³ Po aty, fq.531

²⁴ Dr.Se lman Se lmana j “Fa ktorët limitues që ndikojnë në ngecjen e sendertimit sektorit prinar në Kosovë” Hulu mtim i botuar nga REINVSET Nr.2 ne Prishtinë, fq.103

2.7 Disa nga veçoritë e kriminaliteti ekonomik

Përkundër disa karakteristikave të përbashkëta që ka më kriminalitetin e përgjithshëm dhe atë politik, kriminaliteti ekonomik i ka edhe disa veçori specifike dhe mjaft të theksuara. Njëra ndër karakteristikat e këtij lloji kriminaliteti, si pjesë e kriminalitetit të gjithmbarshëm bashkëkohor, është aftësia e **përshtatjës** së shpejtë marrdhënjëve të reja shoqërore-ekonomike si dhe dispozitave ligjore pozitive që zakonisht i përcjellin ndryshimet e këtilla shoqërore. Si rezultat i kësaj aftësie, janë shfaqur formave të reja të kryerjes të këtij lloji të kriminalitetit si dhe mjetet e metodat gjithnjë e më të reja që kryesit i aplikojnë në aktivitetin kriminal.²⁵

Në të gjitha punime teoriko-shkencore, poashtu akcentohet, se ky lloj kriminaliteti quhet **“kriminalitet i jakës së bardhë”** ashtu siç e ka emërtuar kriminologu amerikan Sutherland. Kjo për arsye se më të shpeshtë të formave të ndryshme të veprimtarisë kriminale ekonomike, kryesisht janë persona zyrtarë, me autorizime të posaçme në ndërmarrje ekonomike, banka, institucione të ndryshme, organe të pushtetit etj. Konsiderojmë se kësaj karakteristike duhet shtuar edhe lidhjet shumë të ngushta që krijohen në mes të këtyre subjekteve me qëllim të organizimit sa më të suksesshem të aktivitetit kriminal. I organizuar kështu, kriminaliteti ekonomik, nganjëherë, sipas mendimit tonë, i merr konturat e kriminalitetit të organizuar i cili gjithësesi, paraqet shkallë shumë të lartë të rrezikshmërisë shoqërore.

Në botën bashkëkohore marrdhënjët në mes të shteteve janë intensifikuar në shumë fusha në veçanti në planin e marrdhënjëve ekonomike. Ekonomia botërore ka tendencë globalizimi dhe subjektet ekonomike në këto raporte janë duke fituar gjithnjë e më shumë autonomi veprimi. Në këto rrethana **“kriminaliteti ekonomik paraqet haptas *tendencë të zgjerimit dhe ekspansionit* në planin ndërkombëtar”**,²⁶ rrethanë kjo që e bën atë edhe më të vështirë për ta zbuluar, ndrikuar e gjykuar pasi që shumë prova materiale, duke mbetur jasht kufinjëve shtetror, bëhen të pa arritshme për organet e zbulimit, ndjekjes penale dhe gjykimin. Njëra ndër karakteristikat, do të thoshim, më theksuar të kriminalitetit ekonomik, sipas mendimit tonë, është **dëmi** shumdimensional i cili me veprimet kriminale ekonomike mund ti shkaktohet vendeve të

²⁵ Dr. Slobodanka Konstantinović i Dr. Vesna Nikolić-Ristavonić; “Kriminologija” Studenstki kulturni centar Niš, Niš 1997, fq. 150

²⁶ Mićo Bošković; “Krimina listić ka metodika I”, Policijska Akademija, Beograd 1998, fq. 287

caktuara. Në rend të parë këtu duhet përmendë dëmet materiale të cilat atakojnë sistemin ekonomik. Ato nganjëherë mund të arrijnë shuma marramendëse ngase në shumë raste kemi të bëjmë me veprimtari kriminale kontinuale të subjekteve të ndryshme.²⁷

2.7 Etiologjia e kriminalitetit ekonomik

Faktorët e shumtë dhe rrethanat shoqërore-ekonomike dhe politike të cilat e favorizojnë kryerjen e veprave penale kundërligjore nga lëmi i kriminalitetit ekonomik, përveç atyre të jashtëm (objektiv) dhe të brendshëm (subjektiv), klasifikohen edhe në ato “të qensishem dhe të drejtëpërdrejt që konsiderohen si *shkaqe* dhe në ata në mënyrë të tërthortë që konsiderohen si *kushte* që kanë ndikim në paraqitjen e disa formave të këtij kriminaliteti.”²⁸

a) Shkaqet e paraqitjes së kriminalitetit ekonomik

Ndër shkaqet kryesore të paraqitjes së kriminalitetit ekonomik janë “kushtet shoqërore e materiale në marrdhënjet ekzistuese ekonomike të shoqërisë, gjegjësisht në antagonizmat e marrdhënjeve shoqërore-ekonomike... në varshmëri të rrethanave politike, ekonomike, gjeografike, juridike, morale, kulturore etj”.²⁹ Ky konstatim argumentohet me kohën e dominimit të pronës shoqërore në sistemin ekonomik-shoqëror socialist kur shpesh ka ardhur deri të kontraditat në mes të kësaj prone dhe Ky konstatim argumentohet me kohën e dominimit të pronës shoqërore në sistemin ekonomik-shoqëror socialist kur shpesh ka ardhur deri të kontraditat në mes të kësaj prone dhe interesave personale të individëve.

Këto kontradita kanë rezultuar më përfitimie të kundërligjshme të pronës shoqërore. Poashtu, më vonë, në periudhen e përpjekjeve për transformimin e pronës shoqërore në ish shtetet socialiste, doemos paraqiten kontradita të caktuara në relacion në mes formave të ndryshme të pronës dhe në mes të këtyre pronave dhe individëve si rezultat të cilave, poashtu, është përvetësimi i kundërligjshëm i pronës së huaj.

²⁷ Dr.Slobodanka Konstantinović i Dr. Vesna Nikolić-Ristanović, Veper e c ituar, fq.151

²⁸ Dr.Ragip Ha lili; “Krimino logjia” Unive rsiteti I Prishtinës, Fakulteti Juridik Prishtinë,fq .180

²⁹ Mićo Bošković; “Krimina listič ka metodika I” , Po lic iska Akademija, Beograd 1998, fq.287

Nga sa u tha mund të përfundohet se aty ku ekzistojnë konfliktet e interesave pronësore dhe ku ekziston pabarazia ekonomike, pabarazia në shkallën e zhvillimit të mjeteve të prodhimit, si dhe aty ku ekzistojnë kërkesat e pakontrolluara e stihike të shoqërisë për të mira më çdo kusht sa më të larta materiale, realisht mund të pritet shfaqja e veprave penale që rrezikojnë ekonominë e një vendi.

b).Kushtet të cilat e favorizojnë kriminalitetin ekonomik

Kushtet të cilat e kanë favorizuar dhe mundësuar veprimtarinë kriminale ekonomike në të gjitha fazat e zhvillimit të sistemit ekonomiko-shoqëror të shteteve e sidomos të atyre socialiste, kanë qenë të shumta.

Ndër to më me ndikim ishin:

- 1) Dobësitë në organizimin e brendshëm të vëllimit dhe mënyrës së prodhimit material dhe afarizmit. Në këtë grup hyjnë edhe ndyshimet e shpeshta të ligjeve dhe akteve të shumta nënligjore me të cilat rregullohet afarizmi e të cilat kryesisht latentë i shfrytëzojnë me shkadhtësi;*
- 2) Mangësitë që lidhen me kontrollin e brendshëm e të jashtëm ekonomik. Kur dihet se mbrojtja e efikase e të gjitha formave të pronës nuk mund të mendohet pa funksionimin e sistemit të kontrollit, atëherë është e logjikshme që në periudhën e funksionimit të sistemit ekonomik socialist, kur disa forma të kontrollit siç p.sh. ishin kontrolli vetqeverisës së puntorëve në ish Jugosllavi, kontrolli i brendshëm etj., duke mos funksionuar në mënyrë të kënaqëshme, kanë mundësuar sulme në ekonominë shoqërore si nga personat në marrdhënje pune në organizatat punuese, ashtu edhe nga personat e tretë. Organet e kontrollit të jashtëm kanë qenë organet inspektuese dhe shërbimi i qarkullimit financiar. Është gjithashtu e njohur se edhe në këto organe kanë ekzistuar dobësi të caktuara në formën e kontrollit të disponimit të ligjshëm të pasurisë. Këto dobësi janë manifestuar jo vetëm në veprimin e tyre shpesh të vonuar, por edhe në aspektin profesional. Në rastet e pengesave të caktuara për ndërmarrjen e masave të ndjekjes eventuale penale, që janë bërë shpesh nga funksionarët politik, këto organe në të shumtën e rasteve kanë lëshuar pe duke i heshtur keqpërdorimet e ndryshme;*
- 3) Lëshimet dhe dobësitë e shumta në kryerjen e inspektimit të veprimtarisë së rregullt dhe gjendje ekzistuese të mallit dhe parasë në objektin e caktuar, si dhe përputhshmëria me gjendjen në kontabilitet. Këto lëshime janë manifestuar në shumë forma siç janë: shkalla e ulët*

profesioanle e antarëve të komisionit që e kanë bërë inspektimin, sjellja e pandërgjegjshme e tyre, kryerja e inspektimit sipërfaqësor për shkak të ndikimeve të caktuara, lidhjeve familjare etj;

4) Mbrojtja e pamjaftueshme fizike dhe teknike e pasurisë, po ashtu, në shumë raste në sistemin socialist është shfrytëzuar për tjetërsimin, përvetësimin, dëmtimin ose sulmin e organizuar në pasurinë shoqërore. Këtu kemi të bëjmë më lëshimet në planin e mbrojtjes fizike të pasurisë nga ana e shërbimeve profesionale të

mbrojtjes fizike si dhe me mos aplikimin e metodave dhe mjeteve bashkëkohore teknike të mbrojtjes;

5) Ndër kushtet tjera përmendën sidomos: dobësitë në politikën kadrovike si rezultat i të cilave ka qenë caktimi i njerzve të paafte, gjegjësisht joprofesional në vende të rëndësishme pune, lidhjet familjare e lidhjet tjera, koncentrimi i dy e më shumë funksioneve në individ, rregullativa e pamjaftueshme ose joadekuate juridike si dhe ndryshimi i shpeshtë i saj, ndikimet negative dhe ndërhyrjet e qarqeve të caktuara në pushet e politikë, etj

2.10 Baza juridike për luftimin e kriminaliteti ekonomik

a) Dokumentet ndërkombëtare

Në të gjitha vendet evropiane është i njohur fakti se kriminaliteti ekonomik paraqet rrezik për ekonominë dhe, rrjedhimisht, edhe për demokracinë në këto vende. Prandaj, nxjerrja e dispozitave ligjore për luftimin e kriminalitetit ekonomik është faktor vendimtar për prosperitetin dhe mirëqenien e të gjithë qytetarëve. Ne, si ekspertë, duhet të jemi të vetëdijshëm edhe për faktin se zbatimi i këtyre dispozitave nuk nënkupton edhe kufizimin e transaksioneve ekonomike të ligjshme, siç është, p.sh., qarkullimi i lirë i mallrave dhe shërbimeve në botën e jashtme. Në luftën kundër kriminalitetit ekonomik duhet të kihet parasysh edhe mbrojtja e të drejtave të ligjshme të të gjithë qytetarëve. Për këtë arsye, në listën e dokumenteve duhet të përfshihet dhe Konventa evropiane për të drejtat e njeriut.³⁰

³⁰ Dr Mersia Suçeska, Bazat e kriminalitetit ekonomik, Prishtinë, FSK/S -07/06, 2006, fq.22

Gjithashtu, duhet të kihet parasysh edhe fakti se çdo vend e ka trashëgiminë e vet të veçantë kulturore dhe traditën juridike. Këto veçanti duhet të merren parasysh gjatë shqyrtimit të ligjeve të reja, në mënyrë që zbatimi i ligjeve të jetë samë efikas, ndërsa bashkëpunimi ndërkombëtar për luftimin e kriminalitetit të jetë sa më i suksesshëm. Përfitimi ekonomik është një prej motiveve themelore të veprave penale, kurse shpesh është motivi i vetëm i malverzimeve. Por, ndonjëherë, përfitimi ekonomik është mjet dhe jo qëllim. P.sh., terrorizimi është një prej qëllimeve. Paratë janë vetëm forcë që vë në lëvizje makinerinë e terrorizmit. Prandaj, mënyra më efikase e luftës kundër kriminalitetit është konfiskimi i profitit të realizuar në mënyrë joligjore, pas kryerjes së veprës penale. Kjo vlen edhe për kriminalitetin ekonomik.

Përveç kësaj, nëpërmjet konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, shoqëria kompenson dëmin e shkaktuar nga kriminaliteti. Pra, konfiskimi është masë me interes të madh shoqëror, e cila është edhe veprim preventiv, njëkohësisht. Rregullat kryesore që kanë të bëjnë me këtë fushë përmblihen në Konventën mbi pastrimin e parave, veprimet hetimore dhe sekuestrimin e konfiskimit të mirave materiale të fituara në mënyrë të paligjshme, të cilat janë miratuar nga Këshilli i Evropës, në vitin 1990. Me këtë konventë janë caktuar rregullat për nxjerrjen e dispozitave shtetërore, si edhe për bashkëpunimin ndërkombëtar. Të gjitha format e kriminalitetit të rëndë janë të lidhura me realizimin e profitit ekonomik. Por, disa vende i përmbahen të drejtës kur bëhet fjalë për kriminalitetin financiar, më çka zvogëlohet mundësia e bashkëpunimit me botën. Nga fushat që kërkojnë përpjekje të veçanta në nivelin ndërkombëtar, zakonisht përmenden kriminaliteti i organizuar dhe tregtia me drogë. Në disa vende, p.sh. ekziston kodi penal që mbron interesat publike dhe private, në bazë të të cilit inicohen procedurat penale për vepra të rënda të kriminalitetit financiar, për vetësimin të mjeteve të Bashkimit Evropian dhe shfrytëzimit të paligjshëm të subvencioneve të fituara nga Bashkimi Evropian. Konfiskimi i mjeteve materiale të fituara në mënyrë të paligjshme mund të jetë i pjesshëm dhe i plotë. Në rast se nuk është e mundur të vlerësohet saktë vlera e këtyre mjeteve, sipas kodeve penale të disa vendeve, mund të bëhet konfiskimi i mjeteve me vlerë të përafërt.

Në këto vende, konfiskimi bëhet edhe në rast se një person tjetër ka marrë përsipër mjetet e fituara në mënyrë të paligjshme, në qoftëse ai person ka qenë në dijeni për veprën penale, në rast se është bërë i shurdhër ndaj dispozitave në lidhje me këtë ose në rast se mjetet e fituara në mënyrë të paligjshme i ka pranuar si dhuratë. Përveç kësaj, në kodet penale të këtyre vendeve janë futur edhe dispozita të reja.³¹

Sipas dispozitave të reja, pasuria e kryesit të veprës së rëndë penale mund të konfiskohet, në qoftë se me kryerjen e veprës penale është realizuar profit i konsiderueshëm material. Në rrethana të tilla, mund të konfiskohet pasuria e bashkëshortit të kryesit të veprës (qoftë me kurorë, qoftë pa kurorë), përveç nëse pasuria është fituar pesë vjet para kryerjes së veprës penale ose në qoftë se pasuria është fituara para krijimit të bashkësisë bashkëshortore. Në Evropë kanë rëndësi të madhe dispozitat që kanë të bëjnë me ndërmarrjet dhe institucionet afariste.³²

Në to, pas së gjithash, përcaktohet se cilët persona fizikë ose juridikë janë pronarë të ndërmarrjeve apo kanë ndikim vendimtar në ndërmarrje. Pjesëmarrja minimale e kapitalit të ndërmarrjes, e parashtruar si parakusht ligjor, mund ta mbrojë organizimin e ndërmarrjes. Në rastet kur, p.sh. pronarit i lejohet të marrë hua nga ndërmarrja, gjithmonë ekziston rreziku nga keqpërdorimi i kapitalit të ndërmarrjes. Shkelja e dispozitave që rregullojnë çështjet e kontabilitetit, çështjet lidhur me revizionin financiar dhe dorëzimin e llogarive vjetore që pasqyrojnë afarizmin dhe bilancin, tërheq me vete përgjegjësinë penale.³³

Në disa vende evropiane, vitet e fundit, ka bankrotuar një numër i caktuar i bankave dhe ndërmarrjeve të mëdha. Është konstatuar se veprimet kriminale në këto ndërmarrje nuk kanë mundur të zbulohen shumë vjet, sepse revizioni financiar nuk është bërë në mënyrë efektive. Gjithashtu, ka pasur raste që korporatat të themelohen me kapital qarkullues, i cili është deponuar në llogarinë bankare me rastin e themelimit ose blerjes së ndërmarrjes, por pas një kohe të shkurtër është tërhequr nga llogaria, për të themeluar apo për të blerë një ndërmarrje tjetër. Për shkak të keqpërdorimeve të shumta, në disa vende të Evropës është krijuar mundësia që në rrugë ligjore, personave të caktuar t'u shkurtohet e drejta e themelimit të ndërmarrjeve ose të drejtimit të tyre. Zvogëlimi të këtij rreziku në disa vende i kontribuojnë dispozitat që rregullojnë

³¹ Dr Mersia Suçeska, Bazat e kriminalitetit ekonomik, Prishtinë, FSK/S -07/06, 2006, fq.22

³² Po aty, fq.23

³³ Po aty, fq.23

identifikimin e qartë dhe kontrollin efikas, kur bëhet fjalë për banka, organizata financiare, shoqëri të sigurimeve dhe shoqëri bankare. Ja disa marrëveshje ndërkombëtare, konventa dhe rekomandime që kanë të bëjnë me kriminalitetin ekonomik:³⁴

1.Kombet e Bashkuara: Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër kriminalitetit të organizuar trans-nacional.

2.Kombet e Bashkuara: 1988. Konventa kundër tregtisë së paligjshme të drogave narkotike dhe substancave psikotropike.

3.Këshilli i Evropës: 1990. Konventa mbi larjen e parave, borxheve, bllokimi dhe konfiskimi i të hyrave nga kriminaliteti.

4.Këshilli i Evropës: Strasburg 1999. Konventa qytetare-juridike mbi korrupsionin.

5.Këshilli i Evropës: Strasburg 1999. Konventa penalo-juridike mbi korrupsionin.

6.Bashkimi Evropian (26/07/1995): Konventa mbi mbrojtjen e interesave financiare.

7.Këshilli i Evropës/OECD 1988: Konventa mbi aksionin e përbashkët bë veprimet doganore.

8.Konventa evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

9.Këshilli i Evropës: 2000, Projekt konventa mbi kriminalitetin kompjuterik.

10.Këshilli i Evropës: 1990, Konventa mbi bllokimin dhe konfiskimin e mjeteve të fituara nëpërmjet veprave penale.

11.Konventa evropiane mbi ekstradimin (1957).

12.Protokolli shtesë i Konventës evropiane mbi ekstradimin (1975).

13.Protokolli i dytë shtesë i Konventës evropiane mbi ekstradimin (1978)

14.Konventa evropiane mbi bashkëpunimin reciprok në rastet penale (1959).

³⁴ Po aty, fq.23

15. Protokolli shtesë i Konventës evropiane mbi bashkëpunimin reciprok në rastet penale (2001).

16. Protokolli i dytë shtesë i Konventës evropiane mbi bashkëpunimin reciprok në rastet penale (2001).

17. Këshilli i Evropës: 1981, Konventa për mbrojtjen e personave në bazë të përpunimit automatik të të dhënave personale.³⁵

18. Protokolli shtesë Konventës së Këshillit të Evropës për mbrojtjen e personave në bazë të përpunimit automatik të të dhënave personale (1981).

19. Këshilli i Evropës: 1988, Konventa mbi ndihmën administrative reciproke në fushën e tatimeve.

20. Konventa e OECD mbi luftën kundër korrupsionit të zyrtarëve të huaj publikë në transaksionet afariste ndërkombëtare.

21. Këshilli i Evropës: 2001, Konventa e Këshillit të Evropës mbi kriminalitetin në internet.

22. Komisioni dhjetë-anëtarësh për rregullativën bankare dhe praktikën e mbikëqyrjes (Komisioni i Bazelit) 1988: Deklarata mbi parimet e parandalimit të përdorimit kriminal të sistemit bankar, me qëllim të larjes së parave.

23. Kombet e Bashkuara: Modeli i ligjit për luftën kundër korrupsionit dhe larjes së parave.

24. Grupi G-7 (ATF) grupi punues për aktivitetet financiare kundër larjes së parave, 40 rekomandime.

25. Bashkimi Evropian: 1991. Direktiva për parandalimin e shfrytëzimit të sistemit financiar për qëllime të larjes së parave.

26. Interpol, 1955, Rezoluta mbi larjen e parave.

27. Komiteti i Ministrave, 1996: Programi aksional kundër korrupsionit.

³⁵ Dr Mersia Suçeska, Bazat e kriminalitetit ekonomik, Prishtinë, FSK/S -07/06, 2006, fq.24

28.Komiteti i Ministrave, 1997: Rezoluta (97) 24 mbi njëzet parimet kryere të luftës kundër korrupsionit.

29.Komiteti i Ministrave, 1998: Marrëveshja për krijimin e „Grupit të vendeve kundër korrupsionit (GRECO).

30.Këshilli i Evropës, Strasburg, 1997: Deklarata dhe plani aksional i luftës kundër korrupsionit.

31.Bashkimi Evropian: Rregullat 1073/1999 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian (25/05/1999) që kanë të bëjnë me hetimet e sektorit evropian për kriminalitetin ekonomik (OLAF).

32.Marrëveshja për themelimin e Bashkësisë Evropiane, 1948.³⁶

2.11 Krimi Ekonomik në Ligjin e RM-së

Me përjashtim të një konflikti të shkurtë në vitin 2001, Maqedonia i shpëtoi shkatërrimit në masë nga lufta dhe shpërnguljes së popullsisë së saj. Si rrjedhojë situatë politike është stabilizuar në vend dhe është krijuar një gjendje sigurie dhe institucionet janë në funksionim. Ligjet ekzsituase u janë bërë ndryshimet e nevojshme, ligjet e reja të miratuara janë në përputhje me standartet dhe rregulloret ndërkombëtare. Procesi i zbatimit është në rrugë e sipër gjë e cila sjell një reflektim pozitiv mbi marrëdhëniet ndër-etnike dhe tolerancën midis komuniteteve të ndryshme që jetojnë në vend. ka filluar refroma gjyqësore dhe është ndërmarrë me sukses zbatimi i reformës politike të vitit 2005 në përputhje me Planin Kombëtarë të veprimit. Neni 29 i Përkurorisë Publike parashikon një përkufizim ligjor të krimit të organizuar i cili është plotësisht i nëpërputhshëm me përkufizimet ndërkombëtare. Gjithashtu në të parashikohen edhe detyrat kryesore të Njësisë së luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Historia e fundit ekonomike e Republikës së Maqedonisë është e lidhur ngushtë me rënien progresive ekonomike të ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ).

³⁶ Dr Mersia Suçeska, Bazat e kriminalitetit ekonomik, Prishtinë, FSK/S -07/06, 2006, fq.25

Që nga momenti i shpërbërjes së Jugosllavisë në fillim të viteve 90 të shekullit të kaluar, ekonomitë e vendeve pasuesekanë rënë në mënyrë dramatike, me një kolaps në prodhimin dhe punësimin, dhe deficitet e përhapura dhe hiperinflacioni. Pas vitit 2001, situata ekonomike në Republikën e Maqedonisë është përmirësuar, me shenja të dukshme të aktivitetit ekonomik dhe dinamizmit, ndërkohë që efektet e krizës globale financiare dhe ekonomike e çuan vendin në një recesion në 2009. Ekzistojnë përpjekje të konsiderueshme në zbatimin e reformave strukturore në Republikën e Maqedonisë për të stimuluar rritjen ekonomike, rritjen e shkallës së punësimit, uljen e varfërisë, tërheqjen e investimeve të huaja dhe pastrimin e parave.³⁷

Lidhur me legjislacionin e brendshëm, Republika e Maqedonisë ka miratuar disa ligje dhe ndryshime në ligjet që rregullojnë parandalimin dhe shtypjen e pastrimit të parave. Mes tyre, mund të dallohen si akte ligjore më të rëndësishme:

- *Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe të ardhurave të tjera nga vepra penale Ligjibankar*
- *Ligji i krimit.*

Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave është baza për luftën kundër pastrimit të parave. Ky Ligji u miratua për herë të parë në vitin 2001 dhe pastaj është përmirësuar dhe është në pajtim me rregulloret ndërkombëtare. Është karakteristike të theksohet se ky ligj përcakton masat dhe veprimet për të zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmi organizimi dhe kontrolli i naplikimin e tyre.³⁸

³⁷ Министерство за финансии (2005) „Национална стратегија за борба против перење на пари и финансирање на тероризам“, Скопје, стр.20

³⁸ Законот за спречување на перење пари и други приноси од казниво Дело и финансирање на тероризам (Службен весник број 04/08, 57/10, 35/11, 44/2012 и 43/14)

PJESA E TRETË

3.1 Analizë krahasuese midis vendeve të rajonit mbi krimin e organizuar (krimi ekonomik) – Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë

Krimi financiar, krim i shekullit 21, është shumë profitabil, pothuajse i paevitueshëm dhe sfidues për t'u ndjekur penalisht nga ana e institucioneve të zbatimit të ligjit. Asnjë shtet, shoqëri apo komunitet nuk mund të jetë imun nga ndikimi i krimit financiar mbi qeveritë, ekonominë, shoqëritë dhe viktimat. Krimi financiar gjithnjë e më shumë është duke u trajtuar në literaturë, për shkak të pasojave dhe efekteve negative të tij në sistemin ekonomik, politik e social, të secilit vend të rajonit e të mbarë botës. Në masë të madhe, efektet negative të krimit financiar janë në: demokraci, investime, standard të jetesës, rritje ekonomike dhe besim në institucione shtetërore, në nivel global, ndërsa efektet më të mëdha negative ndihen te shtetet në zhvillim dhe ato në tranzicion, siç është Kosova. Efekti i parë negativ i krimit financiar është rënia e investimeve, sepse ka efekt negativ mbi investitorët dhe ngecje në zhvillimin ekonomik.³⁹

Një vend shumë i korruptuar ka të ngjarë të jetë një vend ku biznesi operon në një mjedis të pasigurt dhe arbitrar. Një mjedis i tillë inkurajon elitat lokale për të investuar jashtë vendit dhe dekurajon investimet e huaja direkte. Përveç kësaj, ndikon negativisht në shpërndarjen dhe përdorimin efektiv të burimeve ekzistuese në ekonomi dhe shkakton inflacion dhe pabarazi në shpërndarjen e të ardhurave. Kosova gjatë viteve të fundit ka dështuar të krijojë një ambient të përshtatshëm për tërheqjen e investimeve të huaja. Madje, vështirësi kemi pasur që t'i bindim edhe diasporën që të investojë mjetet e tyre në Kosovë. Këtë më së miri e tregon niveli i investimeve të huaja në Kosovë ndër vite. Njëra prej ndikimeve kryesore të krimit financiar është te grumbullimi i tatimeve, sepse është shkatërrues ndaj aftësive të shtetit për mbledhjen e tatimeve/taksave, për zbatimin e politikave koherente dhe racionale të zhvillimit, për të rishpërndarë burimet ndërmjet grupeve dhe rajoneve, dhe si pasojë në aftësinë e tij për të transformuar shoqërinë dhe ekonominë sipas prioriteteve politike. Në Kosovë nuk ka shumë të dhëna se sa është shmangia tatimore. Në një studim të Bankës Botërore tregohet se humbjet më të mëdha në Kosovë janë nga mosmbledhja e TVSH-së. Raporti thotë se 34 për qind e të hyrave nga TVSH-ja nuk hyjnë në arkën e shtetit.

³⁹Ma.Sc.Lirim Dervisholli, "Krimi Financiar – Pengesë për Zhvillim Ekonomiko-Social në Vende të Evropës Juglindore", Prishtinë, 2010, fq.201

Vjedhje ka edhe në tatimet tjera, siç është Tatimi në të Ardhurat Personale dhe Tatimi në të Ardhurat e Korporatave. Përveç kostove direkte, kemi edhe kostot indirekte të krimit financiar të cilat janë të shumta. Organet e zbatimit të ligjit duhet të punësojnë oficerë për të hetuar krimet e tilla, ndërsa prokuroritë/gjykatat duhet të përdorin burimet e tyre të kufizuara për të ndjekur penalisht ata që janë kapur. Për këto raste kemi gjyqe të shtrenjta që kërkojnë ekspertiza të kushtueshme për të shpjeguar krimet e komplikuar. Rregullatorët u kërkojnë monitorim dhe raportim organizatave, në mënyrë që krimet të jenë të detektueshme, kështu që u kushton bizneseve dhe konsumatorëve edhe më shumë. Pastaj, ekzistojnë shpenzime që është gati e pamundur të kuantifikohen, që lidhen me shëndetin dhe sigurinë, që ndodhin për shkak të mashtrimeve mjedisore, në vendin e punës, të kujdesit shëndetësor, etj. Korrupsioni në prokurimin publik paraqet një prej problemeve sociale më të ndërlikuara me të cilin përballen qeveritë sot, sepse dobëson ekonominë, krijon cinizëm në mes shoqërisë civile, dhe në disa raste kërcënon madje stabilitetin e qeverive. Një prokurim publik jotransparent, favorizon biznese joadekuate joeficiente e më të shtrenjta që shpesh janë të lidhura ngushtë me grupe të caktuara të interesit. Pra, nga njëra anë bën që institucionet të marrin shërbime më të dobëta dhe nga ana tjetër shteti të paguajë më shumë. Kjo ndikon që ato biznese të mos perfeksionojnë produktet/shërbimet e tyre, e të jenë më konkurrense në treg, për të konkurruar me produkte/shërbime me bizneset e vendeve të zhvilluara. Nuk mjafton vetëm prokurimi elektronik për të eliminuar korrupsionin në prokurim publik, por kërkohet një koalicion gjithëpërfshirës i bizneseve, shoqërisë civile dhe institucioneve kyçe të shtetit.⁴⁰

Nëpër shtetet në zhvillim, siç është edhe Maqedonia, kemi pasur shumë raste të krimit në privatizim të pronës shoqërore. Në proces privatizimi kemi privatizim të paplanifikuar, të përshpejtuar, jotransparent, shitje shumë të lira, madje edhe pa kushte siç janë rastet e resurseve natyrore të cilave pas një kohe të shkurtër pas privatizimit u ndërrohet tërësisht veprimtaria natyrore. Korrupsioni ndikon më shumë te shtresat e varfra, pasi që ato janë më të cenueshme dhe të varur nga cilësia e qeverisjes dhe përkrahjes shtetërore, ku vjedhja e fondeve redukton burimet për programe dhe investime sociale, si në arsim, shëndetësi, shërbime komunale, etj. Andaj, sa më i shprehur që është i ashtuquajti korrupsion në një vend, aq më e prekur është shtresa e varfër, e cila duhet të ballafaqohet çdo ditë me ekzistencën dhe marrjen e shërbimeve bazike në

⁴⁰Ma.Sc.Lirim Dervisholli, “Krimi Financiar – Pengesë për Zhvillim Ekonomiko-Social në Vende të Evropës Juglindore”, Prishtinë, 2010, fq.201

vend. Për më tepër, varfëria redukton shëndetin psikik të njerëzve, ku të papunësuarit janë të goditur më fort, pasi që tendosja financiare nga papunësia mund të shkaktojë shëndet të dobët mendor. Mungesa e besimit në qeveri dhe gjykata, mund të rezultojë në destabilizim politik si dhe ekonomik, ose të paktën me një mungesë të besimit për investitorë të huaj, ngushton gamën e njerëzve të biznesit të gatshëm për të investuar në vend. Investitorët e ligjshëm nuk mund të jenë në gjendje për të konkurruar me bizneset që mbështeten nga investimet e paligjshme e grupet kriminale. Risku i reputacionit rezulton në të qenërit i perceptuar si një vend që lejon pastrimin e parave. Ky rrezik ka potencial për të shkaktuar deformime makroekonomike, shpërndarje të keqe të kapitalit dhe burimeve, rritje të rreziqeve për sektorin financiar të vendit dhe të dëmtojë kredibilitetin dhe integritetin e sektorëve të brendshëm financiarë dhe sistemin financiar ndërkombëtar. Krimi financiar është në rritje në një shkallë alarmante dhe globalizuese, si gjeografikisht ashtu edhe në larmi, për çka duhet bërë thirrje për veprime urgjente globale. Andaj, kuptimi i thellë i krimit financiar dhe dinamikave të tij në një vend është një hap i parë i domosdoshëm për hartimin e një strategjie efektive të reformave që ia përcakton vendit një rrugë të drejtë integritetit më të madh të qeverisë dhe që rezulton në zhvillim ekonomik.⁴¹

Në radhë të parë është edukimi i të rinjve në lidhje me parimet e qeverisjes demokratike dhe ekonomisë së tregut. Ky është parakusht që të rinjtë dhe qytetarët të kuptojnë se si funksionon një treg i lirë dhe cilat janë të drejtat e tyre. Zakonisht krimet ekonomike e financiare arrijnë të bëhen me ndihmën e grupeve të interesit dhe vendimmarrësve. Natyrshëm, luftimi i krimit në Shqipëri kërkon një vullnet politik për një angazhim më të madh nga ana e qeverive për të njohur natyrën e dëmshme dhe transnacionale të krimit financiar dhe për ta luftuar atë. Kërkohet përmirësimi i ligjeve dhe trupave rregullatorë që ua lehtësojnë institucioneve luftimin e këtij krimi. Në këtë vijë është edhe miratimi dhe zbatimi i ligjit kundër pasurimit të paligjshëm. Kërkohet që të kemi një depolitizim dhe profesionalizim të shërbyesve publikë, sidomos të atyre që punojnë nëpër sektorë të ndjeshëm siç është sistemi financiar apo prokurimi publik. Duhet të ketë një profilizim dhe specializim të zyrtarëve që merren me parandalimin, hetimin dhe gjurmimin e aseteve të përfituara nga krimi.

⁴¹Ma.Sc.Lirim Dervisholli, “Krimi Financiar – Pengesë për Zhvillim Ekonomiko-Social në Vende të Evropës Juglindore”, Prishtinë, 2010, fq.201

Organizatat/bizneset duhet të vendosin politika dhe procedura të duhura, të sigurojnë përmbushjen, të njohin stafin e tyre, furnizuesit, partnerët dhe agjentët, t'u kushtojnë kujdesin e duhur konsumatorëve, të mbajnë të dhëna strikte, të trajtojnë stafin e tyre lidhur me rreziqet, të sigurojnë infrastrukturë dhe staf të specializuar kundër krimit kibernetik, të bëjnë vlerësime të rregullta për risk nga mashtrimet, të raportojnë aktivitete të dyshimta; etj

3.2 Krimi ekonomik si faktor me ndikim në proceset politike – Rasti i veriut të Kosovës

Siguria është kategori kushtetuese në shtetin Juridik, gjë që obligon organet dhe institucionet shtetërore të përmbushin këtë detyrim ndaj qytetarëve, për të cilët siguria është një e drejtë themelore e pa tjetërsueshme. Se sa sot është e mundur të përmbushet ky detyrim kushtetues ndaj qytetarëve dhe në cilin nivel të cilësisë është qështje relative, kur dihet fakti se faktorët sfidues të sigurisë janë gjithnjë në rritje dhe gjithnjë e më shumë është e pa qëndrueshme siguria . Po kështu gjithnjë e më shumë jemi dëshmitarë të gjendjes së imponuar nga faktorët sfidues për sigurinë, ku krimi i organizuar njëri nga këta faktorë themelorë manifestohet si faktor i rëndësishëm e me ndikim , i cili dikton ritëm dhe e determinon fizionominë e jetës politike në përmasa shtetërore regjionale etj. Analizuar nga këndvështrimi i sigurisë dhe aspekti kriminalistik, krimi i organizuar tenton, vepron kah konzervimi “gjendjes ekzistuese”, ku organet e shtetit të Kosovës në rastin tonë konkret nuk kanë pasur qasje, as që kanë pasur mundësi të ushtrojnë juridiksionin në territorin e Republikës së Kosovës, të njohur si shtet në planin ndërkombëtar nga më se nëntëdhjetë shtete.“Krimi i organizuar sot paraqet kërcënimin më të madh për civilizimin njerëzor ,rrënon dhe shkel të drejtat themelore dhe liritë njerëzore, si dhe paraqitet si kërcënim immanent për funksionimin dhe zhvillimin e sistemit shoqëror politik, kështu duke krijuar dhe shtuar pasigurinë e individit dhe të shoqërisë në përgjithësi dhe duke rrezikuar sigurinë nacionale”.⁴²

⁴²Mirza Smaiq, Krimi i organizuar në Bosnje dhe Hercegovinë, Sarajevë, Fakulteti i shkencave Politike-Universiteti i Sarajevës, f. 101.

Është supozim real se pa korrupsionin do të ishte shumë vështirë, bile edhe e pa mundur të zhvillohet krimi i organizuar. Ndryshimet në jetën shoqërore ekonomike diktojnë veprimtari të ndryshuar të krimit të organizuar. Strukturat e krimit të organizuar janë shumështrësore dhe esenca e kësaj forme të kriminalitetit është që të mos e “ndiejmë”, vërejmë. Krimi i organizuar dhe korrupsioni në Kosovë nuk janë të pa vërejtur, shumështrësorë po se po, por edhe të pa vërejtur jo. Megjithatë të procesuar, hetuar dhe gjykuar shumë pak, ngase të parin “e shpëton” i dyti, përkatësisht mos procesimin e krimit të organizuar e mundëson pikërisht korrupsioni, kurse mosprocesimin dhe gjykimin e veprave korruptuese e mundëson hakmarrja dhe pasojat e tjera të ngjashme dhe “super-korrupsioni”.⁴³

3.3 Krimi ekonomik si fenomen kërcues për sigurinë publike dhe sundimin e rendit dhe Ligjin në Republikën e Kosovës.

Në kohën e sotme krimi i organizuar vlerësohet si një rrezik real për sigurinë e çdo vendi, por në mënyrë të veçantë, për sigurinë e vendeve me shtete e demokraci të brishta, që s’kanë as traditën as përvojën e duhur për t’u përballur efektivisht me të. Në këtë këndvështrim, për Ballkanin ky fenomen vlerësohet si rrezik kryesor për sigurinë e secilit vend dhe në përgjithësi të gjithë rajonit e në veçanti vendin tonë Kosovën. Me gjithë progresin e arritur: krijimi i institucioneve nga 1999 megjithatë kemi pasur tre tranzicione ajo e periudhës UNMIK 1999-2008, shpallja e pavarësisë 17 shkurt 2008 dhe ardhja e misionit të ri EULEX 2009 që është bërë për të ndërtuar një të ardhme të re përmes procesit të integritetit në Bashkimin Evropian, në sytë e ndërkombëtarëve rajoni ynë ende vlerësohet mjaft i brishtë dhe sfidues.

Ngjarjet e viteve 1990-1999 në ish Jugosllavi krijuan vështirësi të mëdha jo vetëm për shtetet e reja por edhe në zhvillimet integruese aktuale që këto vende synojnë të mos humbasin shansin për të përgënjeshtuar një epitet tjetër famëkeq, si “strehë e krimit të organizuar”. Në këtë epitet mund të ketë doza ekzagjerimi, por e vërteta për këto 20 vjetët e fundit është se, ndërsa të gjitha llojet e industrive në vendet e rajonit kanë falimentuar, ka lulëzuar një “industri e re”, që punon ditë e

⁴³ Borisllav Petroviq & Bojan Dobovshek, Rrjeti i krimit të organizuar, Sarajevë, Fakulteti Juridik , Universiteti i Sarajevës, 2007 f. 70.

natë me kapacitet të plotë e ajo quhet: industria e krimit të organizuar. Po ashtu sipas vlerësimit të ekspertëve krimi i organizuar përfshihet shprehimisht ndër tre tipat kryesore të kërcënimeve të kohës së sotme në fushën e rendit dhe sigurisë publike dhe në ndikimin dhe impaktin direkt të sundimit të ligjit dhe po ashtu krimi i organizuar shihet si një burim që i ushqen drejtpërsëdrejti këto kërcënime, qoftë atë të konflikteve rajonale dhe ndër etnike dhe terrorizmin. Si veprimtari kundër ligjore që ka në themel fitimin e paligjshëm, krimi i organizuar kërcënon stabilitetin e sundimit të ligjit dhe sfidon e kërcënon pareshtur themelet ekonomike e ligjore të shtetit. Krimi i organizuar, me përqendrimin e saj në krimin ekonomik e financiar, është bërë sot komponentë me trendin në rritje më të lartë në botë, me një përfitim global rreth 1 trilion e 800 miliardë USD në vit. Ndërsa në vendet e Evropës Juglindore numërohen me mijëra kompani dhe banka që menaxhohen nga grupet e Krimit të Organizuar. Vendet e rajonit të Ballkanit, përveç Kroacisë, humbasin rreth 20% -30 të të ardhurave vjetore nga krimi i organizuar. Ky fuqizim është i rrezikshëm, sepse është fuqizim i grupeve kriminale të krimit të organizuar dhe përbën kërcënim kundër shtetit, paqes dhe tendenca e gjetjes së një partneri të mundshëm të terrorizmit ndërkombëtar.⁴⁴

3.4 Krimi Ekonomik në Maqedoni pengon luftën kundër korrupsionit

Maqedonia në indeksin e korrupsionit qëndron në vendin e 64 nga gjithsej 175 vende. Përveç ankesave deklarative se korrupsioni është përhapur nëpër shumë sfera, nuk kemi asgjë konkrete në këtë drejtim. Edhe në Raport progresin e Komisionit European për Maqedoninë thuhet se sa i përket korrupsionit asnjë progres nuk është arritur në të kaluarën për shumë çështje të pazgjidhura. “Korrupsioni mbetet i përhapur. Kapaciteti për ta adresuar (korrupsionin) në mënyrë efektive është duke u penguar nga mungesa e vullnetit politik dhe ndërhyrja e politikës në organet kompetente”. Sipas Sasho Ordanoski, aktivist kundër korrupsionit dhe njohës i çështjeve politike, lufta kundër korrupsionit ngec prapa sepse në Maqedoni pushtetin e udhëheq mafia.

⁴⁴ Mr.sc Fatos Haziri, Krimi i organizuar si fenomen kërcënues për sigurinë publike dhe sundimin e rendit dhe ligjit në Republikën e Kosovës, mundëuar nga http://ëëë.kolegji-juridica.org/neë_ëeb/ëp-content/uploads/2017/03/Mr.-Sc.-Fatos-HAZIRI-Krimi-i-organizuar-si-fenomen-k%C3%ABrc%C3%ABnues-p%C3%ABr-sigurin%C3%AB-publike-dhe-sundimin-e-rendit-dhe-ligjit-n%C3%AB-republik%C3%ABn-e-Kosov%C3%ABs.pdf

Shumë vështirë mund të pritet që mafia ta luftojë korrupsionin, në të cilën vet është e përzier. Praktikisht në Maqedoni nuk mund të flasim për korrupsionin, sepse kemi krim të organizuar që është formë më e lartë se korrupsioni. Dhe në rast kur keni krim të organizuar dhe një strukturë mafioze që qeverisë me vendin, nuk mund të bëhet fjalë për luftë ndaj korrupsioni.

PJESA E KATËRT

4.1 Parandalimi i kriminalitetit

Termi prevencionështë huazuar në mënyrë pragmatike nga vokabulari dhe praktika mjekësore. Në kuptimin e vetë të gjerë janëprofiluar dy përmbajtje themelore të këtij nocioni. I pari prej tyre ka të bëjë me intervenimin si formë primaree prevencionit. Kjo qasje në esencë ka shënuar interveniminndaj dukurive të caktuara me mjete të përcaktuara që më parë. Përmbajtja e dytë lidhet me prefiksin pre që shënon reaksionin e parakohshëm, më saktësisht reaksionin para se të jetë manifestuar dukuria e padëshiruar. Në gjuhën latine, *praeventio*⁴⁵ (*prae-venio, veni, ventum, praeventus, praevenire*) shënon përcaktimin dhe termin e kaloj, arrijë përpara, e kapërcej një dukuri të caktuar, ose si siç do të mund të thuhej në bazë të mendjes së shëndoshë paranalim, mbrojtje paraprake, pengim, shmangie që më parë. Që nga shekulli XV në praktikën angleze socio – politike dhe kriminale – politike përdoret shprehja *prevent* me të cilën dëshirohet të theksohet çdo përmbajtje me të cilën në periudhën e ardhshme do të pengohen sjelljet e dënueshme në kuptim të ngushtë të përcaktimit të tyre.⁴⁶

Nga kategorizimi i cekur më parë, mund të vërejmë se nocioni parandalim përmban në vete të gjitha masat e ndërmarranë mënyrë të planifikuar, të paramenduar dhe të organizuar me të cilat do të bëhen përpjekje të mënjanoen ose së paku të zvogëlohen shkaqet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të sjelljeve të dënueshme (Horvatiq, Cvitanoviq, 1999). Disa autorë me parandalimin nënkuptojnë vetëm atë lloj të aktivitetitqë ndërmerret në drejtim të pengimit të kriminalitetit nga ana e opinionit, bashkësisë lokale, organeve dhe shërbimeve në përgjithësi, (Van, Dijk, De Eard 1991). Lidhur me këtë ata theksojnë se parandalimi nënkupton shumësinë e të gjitha masave, të mjeteve dhe të teknikave jashtë suazës së sistemit tëjurisprudencës penale, që kanë për qëllim zvogëlimin e llojeve të ndryshme të dëmeve tëshkaktuara me vetë ekzekutimin e veprës, që shteti i ka shënuar ose inkriminuar në Ligjin e vet penal si vepër penale. Parandalimi i kriminalitetit përfshin edhe aktivitetet e subjekteve të ndryshme që nënkuptojnë masat preventive. Masat e tilla të parandalimit të kriminalitetit mund të nënkuptojnë: forumet shtetërore dhe forumet me autorizime publike, organizatat joqeveritare, shoqatat, fondacionet private, institucionet e informimit publik, shtypin, mediat elektronike, institucionet edukative, përkatësisht arsimore, rrethin profesional në kuptimin më të gjerë të fjalës, institucionet fetare, familjen si grup fundamental social të çdo shoqërie. Aktiviteti i vetë shtetit në këtë plan fokusohet në miratimin dhe perfeksionimin e projekteve ligjore, d.m.th.me dizajnimin e legjislacionit penal, kurse më

⁴⁵ *Provisio (cautio), onis-ad praecavendum/ad providendum atque praecavendum/apertus, a, um – preventiv)*

⁴⁶veprat penale, sipas kuptimit të ngushtë të nocionit të kriminalitetit, të sjelljeve të dënueshmE

vonë me operacionalizimin përmes masave preventive të policisë dhe të shërbimeve të specializuara shtetërore, që merren me kriminalitetin në kuptim të ngushtë dhe të gjerë të domethënies së tij. Mirëpo, siç e kemi cekur parandalimi i kriminalitetit shumë shpesh ka të bëjë edhe me zbatimin e disa masave nga ana e vetë qytetarëve, qoftë në mënyrë të pavarur, qoftë nëpërmjet disa organeve, shërbimeve të specializuara, pastaj shoqatave të krijuara në mënyrë spontane ose të planifikuara, si dhe të disa sektorëve të tjerë të jetës shoqërore, siç është sektori i informimit etj. (Krivokapiq, 2002).

4.2 Shenjat themelore mbi parandalimin e kriminalitetit me vështrim të shkurtër mbi zhvillimin e tij historik

Parandalimi i kriminalitetit nuk është kurrfarë risie. Në të vërtetë, qysh se njerëzit kanë qenë në pozicion të viktimës, janë paraqitur edhe përpjekjet e mbrojtjes së vetes dhe të mbrojtjes së familjes së vet. Mirëpo, nocioni “parandalimi i kriminalitetit” vetëm para do kohe ka marrë domethënie grumbullit të ideve për luftë kundër kriminalitetit. Në histori mund të identifikohen shumë aktivitete nga e kaluara e afërt që renditen në parandalimin e kriminalitetit. Në të vërtetë, “idetë e reja” dhe teknikat lidhur me parandalimin e kriminalitetit jo rrallë herë janë diçka më tepër se riinkarnim i përvojave të kaluara ose të perfeksionimit të qasjeve themelore në të kaluarën (e largët). Format e prevencionit kanë ndryshuar me të madhe nga shekulli në shekull – prej hakmarrjes përmes përcjelljes, frikësimit, inxhinieringut shoqëror deri te dizajni fizik e më tej. Përgjigjet më të hershme lidhur me kriminalitetin i janë lënë individit ose familjes së tij. Nuk ka ekzistuar kurrfarë forumi shoqëror që do të intervenonte në emër të individit të dëmtuar. Në vend të kësaj, vetëndihma ka qenë e vetmja formë e luftës. Ndëshkimi dhe hakmarrja kanë qenë forca lëvizëse përgjatë tërë historisë së hershme. Lex talionis, parimi “sy për sy”, u ka dhënë legjitimitet aksioneve të individëve, të qytetarëve. Ekzistimi i çfarëdo sistemi formal të kontrollit shoqëror është ide relativisht e re.

Është lehtë e mundur të identifikohet “aktiviteti i policisë” në disa civilizime të mëhershme (siç është Perandoria romake ose Franca). Ato kanë qenë shumë më të koncentruara në qytete, vendosjen e rendit dhe të qetësisë publike kryesisht e ka bërë ushtria, kurse ç’është më

e rëndësishmja, ligjet zbatimin e të cilave e ka siguruar kjo “polici” kryesisht kanë pasur të bëjnë me çështjet e shtetit qendror dhe fiset (përkatësisht mbretin). Për shkak të dobisë së limituar të këtyre formave të hershme të policisë njerëzit kanë pasur nevojë për shfrytëzimin e mëtejshëm të metodave të vetëndihmës. Shpëtimi i atyre që janë më pak të lumtur - Shembull i formës së hershme “ të parandalimit të kriminalitetit” ishte formimi i gjykatës për të mitur dhe të përpjekjeve të saj për luftimin e problemit të varfërisë, të mungesës së arsimimit dhe të edukimit të keq ndër shtresat e ulëta të shoqërisë. Fëmijët merreshin nga familjet problematike dhe fqinjësia në përpjekje që t’ju ofrohet dashuria, edukimi dhe arsimimi i nevojshëm dhe të aktivizohen në jetën produktive. Filozofia parens patriae ishte qëndrimi që të rinjë u nevojitet ndihma, dhe se procesuimi pranë gjykatave të rregullta orientohet në dënimin në vend të parandalimit. Shtojcë e kësaj filozofie ishte zgjerimi i jurisdikcionit të gjykatës së të miturve në veprat statusore. Besohej se shkëlja e orës policore, pirja e duhanit dhe sjelljet e ngjashme (nga të cilat asnjë nuk ishte përfshirë në ligjin penal) ishin indikacione për sjelljen e mëvonshme kriminogjene. Intervenimi lidhur me këto vepra statusore ishte mjet i parandalimi të kriminalitetit të mëvonshëm. Së këndejmi sistemi i të miturve ishte qartë përpjekje e parandalimit të kriminalitetit.

Ndryshimi i teksturës shoqërore - Forma më e njohur e veprimit më të hershëm preventiv lidhet me Projektin e regjionit të Çikagos ku ishte konstatuar se kriminaliteti dhe delikuenca ishin të koncentruar në zonat qendrore të Çikagos. Fluktuimi i përhershëm i popullsisë rezultoi në pamundësinë që njerëzit të bëjnë çfarëdo kontrolli shoqëror mbi individët në atë zonë. Njerëzit më tepër brengoseshin për mirëqenien e situatës së vet dhe braktisjen e asaj zone sesa për përmirësimin e jetës dhe mbetjen në atë zonë. Për këtë arsye kriminelët mund të vepronin po thuaj pa dënim në ato kuarte. Zgjidhja e propozuar ishte puna e përbashkët me popullsinë në ndërtimin e bashkëjetesës, që do t’i inkurajonte njerëzit të mbesin dhe t’i vejnë nën kontroll aktivitetet e njerëzve në atë zonë. Pamja fizike e rrethinës - Parandalimi i kriminalitetit ndoshta kishte marrë nxitjen e vetë më të madhe me aplikimin e pamjes fizike të rrethinës. Të metat identifikoheshin si shkaqe ose nxitëse të sjelljes kriminogjene. Neëman (1972), me profesion arkitekt, kishte paraqitur tezën që karakteristikat fizike të ndonjë zone mund t’u sugjerojnë banorëve dhe kriminelëve potencialë që ajo zinë ose është e ruajtur dhe e mirë, ose është e hapur për aktivitete kriminale. Neëman ishte fokusuar në radhë të parë në mikrozonat e braktisura banesore. Willson dhe Kelling (1982) kishin zgjeruar këtë mendim në blloqe të tëra të qytetit: -

“Dritaret e thyera” kanë të bëjnë me shenjat fizike të moskujdesjes për zonën e caktuar (ndërtesat e braktisura, prania e hedhurinave, dritaret dhe dritat e thyera, grafitet etj) që u sinjalizojnë kriminelëve potencialë se aty nuk është askush që do t’i parandalonte.⁴⁷

4.3 Faktorët që e pamundësojnë zhvillimin e tij

Edhe pse parandalimi i kriminalitetit nuk është asgjë e re, shumë çështje dhe vështirësi duhet ende të zgjidhen. Ndër to janë edhe frika lidhur me bazat e ndryshme teorike për intervenime, implementimi i programeve, realiteti politik në kuadër të të cilit duhet të zhvillohet dhe të ekzistojë cili do program, mbështetja në evoluimin joadekuat, dhe të frikës rreth zhvendosjes dhe difuzionit të dobisë.

Konkurrenca teoretike- një debat i gjerë zhvillohet rreth sqarimit adekuat të sjelljes devijuese. Organizimi i dobët shoqëror, zgjedhja racionale dhe aktivitetet rutinore, shpesh herë merren si baza teoretike për programet e parandalimit të kriminalitetit. Mirëpo, shumë teori të tjera gjithashtu ofrojnë një shqyrtim të vlefshëm mbi intervencat. Teoria e të mësuarit, qasjet zhvillimore, teoria e tendosjes (“stratin theory”) teoria e kontrollit, frikësimi dhe teoritë kritike janë vetëm disa prej suazave potencialetë dobishme që janë ndërmarrë, dhe duhet të merren në konsiderim me rastin e koncipimit prevencionit të kriminalitetit. Një theks më i madh duhet të vihet mbi zhvillimin teoretik të programit për parandalimin e kriminalitetit.

Implementimi i programeve - Çështje kyçe për çdo program është niveli deri në të cilin implementohet programi në mënyrë adekuate. Intervенimet që implementohen dobët ose vetëm pjesërisht kanë pak gjasa për sukses, pa marrë parasysh ekzistimin e qëllimit të mirë ose të përgatitjes së mirë (p.sh. për modelin e rojës në fqinjësi në zonën që është e përfshirë në kriminalitet dhe që është e ndarë etnikisht, në kuadër të së cilës arrihet të sigurohet pjesëmarrja e 20% të banorëve, prej të cilëve të gjithë vijnë ekskluzivisht nga një ose tri grupe etnike, nuk duhet pritur se dotë ketë tepër efekt në mbarë fqinjësinë ose bashkësinë).

Elementet kyçe të rojës së suksesshme në fqinjësi nuk do të realizohen nëse nuk mund të sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve.

⁴⁷ Elmedin Muratbegović, Parandalimi i kriminalitetit (compendium of crime prevention and crime control), Sarajevë / Prishtinë, Prill, 2007, fq.113

Problemet rreth implementimit mund të jenë të ndryshme:

- *Parafytyrimi i keq mbi problemin;*
- *Angazhimi i ekspertëve dhe/ose sigurimi i mjeteve të rëndësishme financiare;*
- *Mungesa e resurseve (kadrovike edhe monetare) etj.*

Edhe një problem potencial është frika që agjencionet kyçe, akterët ose anëtarët e bashkësisë marrin pjesë pa dëshirë. Ndoshta kjo pjesërisht ka lidhje me atë qëndrimin “ne kundër tyre” midis policisë dhe qytetarëve që është paraqitur me kohë, sidomos në qytete të mëdha. Mënjanimi i këtyre qëndrimevedhe i frikave nuk ishte i lehtë, për çka dëshmon rezistenca e policisë që bashkësia të merret me punë policore (ndjenja e policisë se ata janë profesionistë sepse janë të trajnuar, kurse qytetarët nuk janë ose frika se do të kthehet koha e drejtësisë vigjilente). Roli i politikës - në përgjithësi, shumë njerëz do të thonë se politika luan rol vendimtar në atë se parandalimi i kriminalitetit a i zgjidhë problemet e drejtpërdrejta kriminaliteti dhe viktimizimi) ose shkaqet reale të problemeve (siç janë varfëria, pabarazia ekonomike, dobësia). Shumica si e kriminelëve ashtu edhe e viktimave vijnë nga grupet pa të drejta në shoqëri dhe këto grupe kanë aftësi të vogël ose kurrfarë aftësie politike dhe ekonomike me anën e së cilës do të mund të përmirësonin statusin e vet. Teoricieni i konfliktit do të sugjeronte ndryshime radikale në sistemin shoqëror në mënyrë që vërtetë të bëhej ndikim mbi kriminalitetin. Më pak ekstrem është distinkcioni i Hopes (Hope, 1995) i dimensionit horizontal dhe vertikal të fuqisë. Dimensioni horizontal ka të bëjë me shkëmbimin e përvojave dhe të aksioneve në nivelin lokal midis popullsisë dhe qytetarëve në zonën e dhënë, kurse masa deri në të cilën popullsia lokale do të mund të realizonte midis vetes raporte të afërta dhe të punojë së bashku, do të ndikojë me të madhe në efikasitetin e cilitdo program të parandalimit. Fuqia vertikale ka të bëjë me aftësinë e grupeve lokale që të sigurojnë përkrahjen dhe të iniciojnë aktivitetet tek elementet e tjera të bashkësisë ose të shoqërisë. Edhe dimensionit horizontal edhe ai vertikal duhet të funksionojnë në mënyrë që parandalimi i kriminalitetit të jetë efikas. Evoluimi i keq - parandalimi i kriminalitetit ka të njëjtën të metë si edhe shumë intervenime – evolucionet e dobëta ose mosekzistuese.⁴⁸

Shumë evolucione trajtohen si çështje e dorës së dytë e disai bashkangjiten projektit në çastin e fundit. Për këtë arsye evolucioni është paramenduar keq, është financuar keq, është i

⁴⁸ Elmedin Muratbegović, Parandalimi i kriminalitetit (compendium of crime prevention and crime control), Sarajevë / Prishtinë, Prill, 2007, fq.25

vonuar dhe afatshkurtër. Evolucionit i programit do të duhej të ishte pjesë përbërëse e planifikimit të cilitdo intervenim. Tek parandalimi i kriminalitetit mund të identifikohen dy tipa të evolucionit.

1. Evolucionit i procesit është unik dhe njëherësh më dominant. Ai fokusohet në atë që është bërë, kush e ka bërë, sa ka ndodhur kjo shpesh, sa njerëz kanë qenë të inkuadruar, si dhe në masat e tjera të ngjashme. Sipas rregullës e shpallin suksesin kur arrihet niveli i caktuar i pjesëmarrjes, i implementimit ose i mbulimit. Ajo që kësaj qasjeje i mungon është vlerësimi i efektit ndaj kriminalitetit dhe viktimizimit. Këto evolucione në këtë aspekt më së shumti janë ofruar me faktin që përmbajnë përshtypjet e njerëzve mbi suksesin. Mjerisht, ky tip i evolucionit edhe sot paraqitet tepër shpesh.

2. Evolucionit i rrjedhësorë i efektit është formë më e dobishme e evolucionit. Kjo kryesisht përfshinë informatat mbi procesin, a ka arritur intervenimi përfundimin e pritur – që është kryesisht dukuri e zvogëluar e kriminalitetit dhe e viktimizimit. Vlerësimet e këtij tipi kërkojnë më shumë planifikim dhe përpjekje. Kujdesi duhet t'i përkushtohet zgjedhjes së grupeve që renditen, kornizës kohore të përcjelljes, masave të variabla të përfundimit, faktorëve potencialë pengues, dhe teknikave analitike. Mirëpo, dy çështje të ndërlidhura që paraqiten në çdo diskutim mbi parandalimin e kriminalitetit janë zhvendosja e kriminalitetit dhe difuzioni i dobisë ("displacement and diffusion")⁴⁹

- Zhvendosja e kriminalitetit ka të bëjë me idenë që në vend që të eliminohet kriminaliteti ose viktimizimi, intervenimet thjesht orientohen në zhvendosjen e kriminalitetit nga një zonë në tjetrën, zhvendosjen e kriminalitetit në caqe të reja brenda të njëjtës zonë, ndryshimin e metodave që shfrytëzohen për kryerjen e një veprë penale, dhe nxitja e kriminelit për ndryshimin e llojit të veprës penale që e ushtrojnë).

- Difuzioni i dobisë sugjeron që aksioni preventiv nuk sjellë vetëm dobi për zonën ose grupin e caktuar, por zvogëlon edhe dukurinë e kriminalitetit dhe të viktimizimit tek të tjerët që nuk kanë qenë në shënjestër (p.sh. nëse instalimi i stabilimentit kundër vjedhjes në ndonjë shitore zvogëlon edhe vjedhjen e artikujve të pambrojtur, do të konsiderohej si difuzion i dobisë). Problemi kryesor tek zhvendosja dhe difuzioni qëndron në vështirësinë e vlerësimit të tyre. Që njëra prej këtyre të dyjave të identifikohet, ndoshta do të duhej evolucionit që do t'i synojë njerëzit dhe vendet, e jo pjesën e programit të parandalimit. Zhvendosja dhe difuzioni janë

⁴⁹Po aty, fq.26

shumë të rëndësishme për evoluimin e programeve dhe do të duhej të nkuadroheshin shprehimisht në dizajnin e programeve dhe të evolucioneve të tyre.

4.4 Parimet themelore të parandalimit bashkëkohor të kriminalitetit

Politika bashkëkohore e kriminalitetit përpiket që strategjinë shoqërore të kundërvënies ndaj kriminalitetit ta vendosë në parime të caktuara qëreciprokisht nuk do të duhej të kundërviheshin pa marrë parasysh faktin që vetvetiu përmbajnë segmente të ndryshme të realitetit shoqëror. Duke u nisur nga qëllimi i politikës së kriminalitetit, që është e harmonizuar me bazën aktuale dhe reale politiko – ekonomike, sociale dhe kulturo – historike, dhe që është i orientuar në luftimin dhe pengimin sa më të suksesshëm të kriminalitetit, është plotësisht e sigurt se politika e kriminalitetit është e domosdoshme të definohet më parë, përkatësisht të shihenedhe parimet e saj themelore. Me këtë, parimet e parandalimit të kriminalitetit janë në lidhje të ngushtë me parimet themelore të politikës së kriminalitetit, përkatësisht parimet themelore të parandalimit të kriminalitetit është e pamundur të kuptohen pavarësisht nga parimet e politikës së kriminalitetit, pasi që ato në një masë të madhe janë të harmonizuara, përkatësisht janë të përputhshme. Diferencat natyrisht dalin nga raportet e komponentëve themelorë të politikës së kriminalitetit: represioni penal – juridik dhe parandalimi shoqëror i kriminalitetit.

Parimet themelore të parandalimit të kriminalitetit janë:

Parimi i ligjshmërisë,

Parimi i legjitimitetit,

Parimi i institucionalitetit,

Parimi i individualizimit,

Parimi i interaksionit,

Parimi i humanitetit.⁵⁰

Është plotësisht e sigurt se të gjitha këto parime, individualisht ose në bashkëveprim, kanë kuptim vetëm nëse plotësojnë qëllimin themelor kriminalo – politik që konsiston në

⁵⁰ Elmedin Muratbegović, Parandalimi i kriminalitetit (compendium of crime prevention and crime control), Sarajevë / Prishtinë, Prill, 2007, fq.26

suksesin e kundërvënies ndaj kriminalitetit, natyrisht me kusht të veprimit ligjor, human, legjitim, me ruajtjen e plotë të të drejtave dhe të lirive të njeriut.

4.5 Tipologjia e parandalimit të kriminalitetit

Me masat e parandalimit të kriminalitetit nënkuptojmë aktivitetet e organeve shtetërore dhe të organeve të tjera të orientuara në pengimin e dukurive negative shoqërore, që prodhojnë pasojatë ndaluara dhe të dëmshme, dhe krijojnë kushte për luftimin e tyre. Diferencimi i masave të parandalimit shoqëror të kriminalitetit zbatohet duke pasur parasysh aspektin e qëllimit të orientimit kriminalistik të shteteve përkatëse (Horvatiq, Cvitanoviq, 1999). Në këtë vështrim strategjitë preventive klasifikohen në mënyra të ndryshme duke pasur parasysh kriterine zhvillimit të klasifikimit dhe natyrisht në bazë të aspekteve themelore që e bëjnë veprimin kriminal. Fjala është për kryesin e veprës penale, vendin (situatën), akterin dhe ligjin. Për këtë arsye është e domosdoshme të cekën edhe disa ndarje themelore të këtyre masave të parandalimit sipas aspekteve të ndryshme. Aspekti i parë është ndarja e masave të parandalimit të kriminalitetit sipas llojit të masave. Sipas këtij kriteri në masa të parandalimit të kriminalitetit numërojmë: masat ekonomike dhe sociale, masat arsimore dhe masat e politikës kulturore, masat teknike. Ndarja më e gjerë e parandalimit të kriminalitetit do të nënkuptonte dy kategori themelore: proaktive – ante delictum dhe reaktive – post delictum dhe ato masa që janë të kontinuuara (të përhershme) dhe të diskontinuuara, të përkohshme) (Krivokapiq, 2002).

Natyra e llojllojshme e kriminalitetit natyrisht kushtëzon edhe reaksione të ndryshme në pengimin e tij. Lidhur me këtë nuk mund të flasim për metodologjinë universale të implementimit të parandalimit. Disa autorë konsiderojnë se çdo mjedis dhe situatë në të përshtat dhe kërkon masa dhe mënyra të ndryshme të reaksionit ndaj kriminalitetit (koncepti i kameleonit). Diferencimi i masave preventive sipas grupeve kanë të bëjnë me: parandalimin e orientuar në ndryshimin e legjislacionit penal, parandalimin e orientuar në situatat potenciale (vendet e vatrës së krizës), parandalimin e orientuar ndaj kryesit ose grupeve të kryesve, në viktimën ose akterët e situatës në përgjithësi. (Hughes 1998). Diferencimi diçka më i ngushtë i masave sipas të njëjtit parim matet sipas: të miturve, personave me pengesa të rënda shpirtërore, vartësve, shtresave marginale (bredhësve, prostitutave, lypsave...), recidivistëve, tipave të veçantë të

kryesve duke pasur parasysh specifikumet e grupeve përkatëse të delikteve, të viktimave potenciale të sjelljeve kriminale. (Pease, 1994).

Diferencimi tjetër ka të bëjë me teorinë në të cilën zbatohen masat e parandalimit. Lidhur me këtë, masat ndahen ato që zbatohen në territorin e gjithëmbarshtëm të shtetit, vetëm në zonat urbane, zonat ruraleose tani të praktikës gjithnjë e më të pranishme të zbatimit në nivelin e bashkësisë lokale në kuptimin më të ngushtë të fjalës (bashkësitë lokale, kuartet...).(Horvatiq, Cvitanoviq, 1999). Parandalimi primar (vepron në opinion dhe në rrethinë në përgjithësi) dhe realizohet përmes përmirësimit të kushteve të përgjithshme sociale, më saktësisht përmes mënjanimi të shkaqeve më të thella të kriminalitetit.Shfaqja e tij është më e shprehur përmes aktivitetit të integritit social, mënjanimi të pengesave sociale dhe zvogëlimit të strukturave të ndryshme që inklikojnë drejt mileut kriminal.Ai zbatohet në mënyrë primare ndaj të miturve, të të papunëve, të papërshtaturve (kategorive të rrezikshme) etj.(Northoff, Stroth, 1996).

Parandalimi sekondar është objekti më i shpeshtë në të cilin e fokuson kujdesin policia. Pra, lloji i këtillë i aktivitetit (programi) nënkupton identifikimin e zonës brenda bashkësisë lokale me shkallën më pak ose më shumë të shprehur të kriminalitetit. Fokusin e interesimit e paraqesin vetë shkaqet e kriminalitetit (etiologjia), me qëllim të luftimit ose të zvogëlimit të llojeve specifike të sjelljeve të ndaluara të individëve ose të grupeve. Programet e përgjithshme të masave të parandalimit, kryesisht përfshijnë mbikëqyrjen, përcjelljen e kriminalitetit në kuadër të bashkësive lokale, veprimtarinë e patrullës kujdestaredhe zhvillimin e programeve që janë tëorientuara në rend të parë në veprat specifike penale etj. Këtu mendojmë në radhë tëparë për disa lloje të delikteve pasurore, siç janë grabitjet, vjedhjet e automjeteve, vjedhjet në shitore, vjedhjet me thyerje të banesave, të automobilave dhe të lokaleve afariste, dhuna në familje, në shkollë, keqpërdorimet e drogave (Kratocki, 1998).

4.6 Teoritë kriminologjike – mbi parandalimin e kriminalitetit

Të gjitha teoritë mbi kriminalitetin mund të fokusohen në një ose më shumë aspekte të vetë fenomenit të kriminalitetit, d.m.th.në ligjin, situatën, kryesin, viktimën ose vëzhguesin. Ky koncept është e domosdoshme të kihet parasysh me rastin e kuptimit të teorive përkatëse mbi

parandalimin e kriminalitetit sepse me këtë fitohet një njohuri për të gjitha premiset teorike dhe empirike tëkonsekuencave që pasojnë nga ato teori. Në vazhdim do t'i paraqesim disa prej teorive që NË opusin e vet i kushtojnë kujdes parandalimit të kriminalitetit.⁵¹

4.6.1 Teoria klasike

Teoria klasike njëkohësisht paraqet pikën bazë në trajtimin e kriminalitetit dhe parandalimin e tij. Lindja e saj madje mund të lidhet me vitin konkret (1764, dhe për emrin e Çezar Baker. Teoria klasike si bazë për perspektivën e vet i merr ndryshimet në ligjin penal, që duhet të veprojnë si masa të frikësimit ndaj delinkuentëve potencialë. Frikësimi i tillë pushon, kurse mbetet një nga masat themelore të veprimit preventiv ndaj kriminalitetit. Dallimet midis përpjekjes prej pionieri të Bakerit që të gjejë moduse ligjore në luftë kundër kriminalitetit dhe të gjendjes që ka sunduar në këtë fushë para tij qëndron në faktin që veprimi ndaj kriminalitetit në periudhën paraprake ishte kufizuar në frikësimin anarkik, diskualifikimin total të delikuentit dhe masat joproporcionale më të ashpra për çdo delikuencë të mundshme. Koncepti i tillë shpinte në situatat që delinkuentët çdo herë më me dëshirë përcaktoheshin për vepra më të rënda penale sepse sanksionet e ashpra u pasonin pa marrë parasysh peshën e veprës penale që e bëjnë.⁵²

Mirëpo, në këtë situatë delinkuentët në përgjithësi ishin në përparësi, sepse nuk ekzistonin kurrfarë shërbimesh të veçanta që do të luftonin në mënyrë efikase kundër aktivitetit të tyre. Me këtë edhe rreziku që kryerësi “ të kapet” ishte shumë më i vogël se sa “fitimi” eventual që realizohet me kryerjen e vetë veprimit kriminal.

Përkundër kësaj, qasjen klasike në parandalimin e kriminalitetit me anë të frikësimit – si masë të parandalimit – e ka mbështetur në dy supozime. Së pari në përcaktimin e shkallës së proporcionalitetit, në bazë të së cilës për veprimet specifike kriminale përcaktohen dënime të caktuara, dhe së dyti, në përcaktimin e metodave të caktuara që do të garantonin se frikësimi do të zhvillohet me sukses. Këto dy boshte, që i ka parashtruar teoria klasike, mbasin deri në ditët e

⁵¹ Elmedin Muratbegović, Parandalimi i kriminalitetit (compendium of crime prevention and crime control), Sarajevë / Prishtinë, Prill, 2007, fq.45

⁵² Po aty, fq.45

sotme masa që shqyrtohen dhe aplikohen në mënyrë standarde në legjislacionet penale të shoqërive të ndryshme.⁵³

4.6.2 Teoria neoklasike

Për shkak të të gjitha dobësive dhe lëshimeve qysh në gjysmën e parë të shekullit XIX teoria klasike kishte përjetuar plotësime të domosdoshme që deri diku i kishin korrigjuar lëshimet qenësore për të cilat bëmë fjalë. Përfaqësuesi i revizionit të teorisë klasike ishte Xheremi Bentam. Ky teoricien me të liberalizmit dhe të utilitarizmit politik. Merita e tij për botëkuptimet themelore të shoqërisë dhe të politikës është e madhe, natyrisht nga aspekti i primeve themelore në të cilat ishte zhvilluar shoqëria moderne civile. Në teorinë e vet politike Bentam është trashëgimtar i utilitarizmit të Makiavelit, i cili po ashtu ishte reformuar dhe orientuar në drejtim të të gjithë qytetarëve, e jo të grupeve të veçanta oligarkike politike. Derisa Makiaveli për politikën fliste në dritën e marrjes dhe të ruajtjes së pushtetit pa marrë parasysh mjetet që duhet të përdoren për realizimi e këtij qëllimi (qëllimi arsyeton mjetin) utilitarizmi i Bentamit kufizohet në parimin “e mira më e madhe për numrin më të madh të mundshëm të qytetarëve”.⁵⁴

Parimi i tillë utilitarist mjaft shpejtë dhe lehtë u bë parim politik i veprimit të forcave politike qytetare, njësoj siç ishte bërë parim populist në të cilin thirreshin vetë qytetarët. Në frymën e populizmit të vet utilitarist, Bentam kishte bërë plotësime të caktuara të vet teorisë klasike, plotësime që, siç ishte dëshmuar, në formën e masave konkrete të politikës preventive mjaft shpejtë kishin gjetur aplikim në praktikën e një numri të madh të shoqërive qytetare.

Edhe pse besonte sinqerisht në natyrën racionale të njeriut, Bentam kishte parë se ekzistojnë njerëztek të cilët instikti hedonistik është shumë më i shprehur nga ai racional në ta. Prandaj, risia e parë në teorinë klasike që e kishte aplikuar Bentam është të kuptuarit e njeriut siqenie racionale, por që termi racional, vihet në kllapa dhe mendohet në potencën. Kjo do të thotë, se njeriu do të duhej të ishte qenie racionale, e nëse nuk është i tillë ekziston problemi që

⁵³ Elmedin Muratbegović, Parandalimi i kriminalitetit (compendium of crime prevention and crime control), Sarajevë / Prishtinë, Prill, 2007, fq.46

⁵⁴ Po aty, fq.47

do tëkorrigjohej në atë mënyrë që ata që nuk janë të tillë duhet të transformohen në drejtim të racionalizimit.⁵⁵

Me fjalë të tjera, teoria neoklasike në këtë mënyrë afirmon parimin e risocializimit të kriminelëve, e kjo është diçka që bëhet pjesë përbërëse e të gjitha aktiviteteve preventive në të gjitha shoqëritë. Në kriminologjinë moderne qasja e tillë definohet si “parandalim reaktiv”, d.m.th. ajo formë e parandalimit që është rezultante e luftës kundër kriminalitetit vetëm pasi të bëhet veprimi kriminalistik. Në terminologjinë e sotme tipi i tillë i veprimit preventiv më së shpeshti kualifikohet si luftë kundër recidivizmit, kurse në tipologjinë klasike të kriminalitetit qasja e tillë mund të renditet në kategorinë e parandalimit terciar.⁵⁶

4.6.3 Pozitivizmi

Pozitivizmi nuk është vetëm teori e rëndomtë shkencore, që zhvillohet në një numër të madh shkencash, por në radhë të parë është një lëvizje shpirtërore, që përcaktonte klimën intelektuale në periudhën e zhvillimit të shoqërisë kapitaliste. Si revolucion tipik shpirtëror pozitivizmi veçohet me natyrën “reaktive”, kurse reaksioni i teoricienëve të orientuar pozitivisht ishte i përqendruar në mënyrën religjioze, d.m.th. metafizikët të menduarit që me shekujka dominuar në periudhën e shoqërisë tradicionale mesjetare. Kështu, premisa e parë dhe elementare pozitiviste bëhet qëndrim konsekuent antimetafizik. Pozitivistët, pra, konsiderojnëse mund të ndërtohet një sistem alternativ i sqarimit të dukurive në shoqëri dhe në jetë. Madje një mënyrë e atillë që do t’i përjashtojë presupozimet metafizike, d.m.th. presupozimet që në asnjë mënyrë nuk mund të provohen.

Me këtë pozitivizmi, në ikjen e vet nga metafizika, i qaset realitetit si të tillë, dhe e tërë lëvizja pozitiviste mund të karakterizohet si empirizëm. Realiteti, çfarë është dhe çfarë ekziston, duhet të jetë bazë për lindjen e të gjitha nocioneve dhe kategorive me të cilat sqarohet.

⁵⁵ Elmedin Muratbegović, Parandalimi i kriminalitetit (compendium of crime prevention and crime control), Sarajevë / Prishtinë, Prill, 2007, fq.47

⁵⁶ Po aty, fq.48

Dukuritë në natyrë dhe në shoqëri mund të vrojtohen, prandaj vrojtimi, d.m.th.përvoja shqisore bëhet parim fundamental metodologjik në të cilin ndërtohet qasja pozitiviste. Pasi që dukuritë e tilla mund të njihen me anë të shqisave, pozitivizmi ka zhvilluar një varg të tërë mjetesesh dhe metodash për matjen e atyre dukurive, dhe nga këto suaza në empirizëm zhvillohet një numër i madh metodash të cilat mundësojnë që dukuritë në natyrë dhe në shoqëri të analizohen nga këndi i tyre kuantitativ.Kuantifikimi, pra, është egoja vitale e mënyrës pozitiviste të të menduarit. Pasi që dukuritë mund të vrojtohen dhe të maten, pozitivizmi deri në fund i ka zhvilluar të gjitha parimet kyçe epistemologjike të shkencës – objektivitetin dhe verifikueshmërinë. Pozitivistët pohojnë se njohuritë të cilat i marrin me anë të metodës pozitiviste janë të vërteta, objektive dhe të verifikueshme, pikërisht për arsye se mbështeten në përvojë.⁵⁷

4.6.4 Teoria e dizajnit të mjedisit

Teoria e dizajnit të mjedisit në esencë në suazat e klasifikimit mund të renditet në teori, d.m.th.në kriminologjinë e mjedisit. Arsyeja pse kjo teori ka marrë trajtim të veçantë qëndron në specifikën e saj, nga njëra anë, dhe në përdorimin e saj në praktikën e deritashme preventive, nga ana tjetër.Përveç kësaj, teoria e dizajnit në aspektin sinkronik i paraprinte kriminologjisë së mjedisit dhe teorive situacionale, dhe në vështrimin epistemologjik mund të pranohet fakti se pikërisht kjo qasje përbën esencën e teorive që janë zhvilluar prej saj.Teoria e dizajnit është inspiruar me konstatimet e Shkollës së Çikagosqë vënin në dukje se ekziston një lidhje e caktuar midis zonave përkatëse urbane dhe shkallës së kriminalitetit.Në këtë gjurmë teoricienët e dizajnit të mjedisit kanë vazhduar me hulumtimet dhe kanë vënë në dukje faktin që midis dizajnit të caktuar fizik të mjedisit dhe të kriminalitetit ekziston lidhja.Kjo e dhënë ishte arsye e mjaftueshme që teoricienët e dizajnit të argumentojnë se si shkakët themelore të kriminalitetit janë karakteristika fizike të asaj pjese të hapësirës urbane ku paraqitet kriminaliteti.Prandaj, vetë ideja e veprimit preventiv në esencë është e thjeshtë dhe kufizohet në konstatimin se është e

⁵⁷ Elmedin Muratbegović, Parandalimi i kriminalitetit (compendium of crime prevention and crime control), Sarajevë / Prishtinë, Prill, 2007, fq.48

domosdoshme të ndryshohet dizajni fizik në ato pjesë të qytetit në të cilat është përgjegjëse për shkallën e lartë të kriminalitetit.⁵⁸

4.7 Parandalimi situacional i kriminalitetit

Në esencë, ideja e teorisë së mjedisit është pothuaj e njëjtë me idenë e dizajnit të mjedisit, e kufizohet në faktin që me kontrollin e mjedisit dhe të kushteve në të cilat ndodhë kriminaliteti të veprohet në mënyrë preventive. Mirëpo, nëse në bazë të kriterit të raporteve midis të përgjithshmes dhe të veçantës do të ishte e arsyeshme që teoria e dizajnit të konsiderohet një nga teoritë e mjedisit, këtu teoria e dizajnit është dhënë si koncept i veçantë për dy arsye. Së pari, në aspektin kohor teoria e dizajnit ka lindur para konceptit të teorisë së mjedisit, edhe pse kjo e dyta logjikisht e përfshin. Pothuaj të gjithë autorët që merren me parandalimin e kriminalitetit e ndajnë teorinë e dizajnit si të veçantë. Përveç numrit të madh të ngjashmërive midis këtyre dy teorisë mund të konstatohen edhe disa diferenca teorike. Edhe pse të dy teoritë mbështeten në presupozimin mbi parandalimin e kriminalitetit me anë të ndikimit në mjedis (vend), kriminologjia e mjedisit vendin e kupton në mënyrë më konkrete, sesa është rasti me teorinë e dizajnit.⁵⁹

Pra, kjo e dyta, ka parasysh aspektet “arkitektonike” të zonës urbane dhe parandalimin e kupton si intervenim në dizajnin arkitektonik, kurse teoria e mjedisit me mjedisin kupton grumbullin e kushteve konkrete në të cilat zhvillohet aktiviteti kriminal. Ndërkaq, në praktikë në nivel të aplikimit konkret të masave që propozohen si strategji preventive, diferencat që i cekëm thjeshtëhumben, dhe prapë mund të vërehet uniteti midis këtyre dy qasjeve teorike. Kriminologjia e mjedisit orientohet në dy aspekte të veprimit kriminal: në qëllimin dhe vendin, me ç’rast theksi vihet në “vandin”. Ndërkaq, ligji, i fajësuarit dhe viktimës nuk janë në fokus të teorisë. Teoricienët e këtij orientimi i argumentojnë pohimet e veta me të menduarit se të gjitha presupozimet që ofrojnë sociologjia dhe psikologjia, e që kanë të bëjnë me motivimin e delikuentit në esencë nuk mund të provohen, dhe sjellja e delikuentit dhe e viktimës në ato baza

⁵⁸ Po aty, fq.49

⁵⁹ Bavcon, Q., Problemi naše kriminalne politike
, Pregled, br. 6/1960

nuk mund as të parashihen me siguri. Pa parashikim të sigurt strategjia preventive nuk ka shumë gjasa për sukses. Kështu, edhe vetëm sjellja e viktimës dhe e delikuentit në këtë kornizë teorike nuk merret si variabël vetvetiu, por në radhë të parë kuptohet si përgjigje individuale në nxitjet nga mjedisi. Me një qasje të tillë hapet rruga që me masat që janë orientuar në mjedis, të ndikohet në sjelljen e akterit të veprimit kriminal.⁶⁰

Kjo lidhje midis mjedisit dhe sjelljes, edhe pse është parashtruar në mënyrë njëdimensionale dhe mekanike, prandaj ka edhe disa dobësi, megjithatë është bazë e mirë për strategjinë preventive. Argument kyç që ceket në arsyetimin e strategjive preventive që janë të orientuara në rregullimin e mjedisit, është që vetëm vendi në të cilin ndodhë vepra penale sqaron cilat janë rrugët dhe mënyrat që viktimat dhe delikuentët i sjellin në situatë që mund të kualifikohet si kriminale. Kështu, nga kjo perspektivë zhvillohen disa qasje specifike ndaj kriminalitetit dhe parandalimi që do t'i paraqesim në tekstin që pason.

PJESA E PESTË

⁶⁰ Bavcon, Q., Problemi naše kriminalne politike, Pregled, br. 6/1960

5.1 Koncepti i hulumtimit dhe rezultatet

Gjatë hartimit të punimit të masgjistraturës kemi përdorur metoda të ndryshme. Koncepti teorik i punimit është realizuar, kurse në konceptin metodologjik do të shfaqim disa pika dhe rezultate kundrejt ‘krimit të jakave të bardha’ në vendin tonë dhe rajon.

5.2 Metodat e hulumtimit

Hulumtimi është bazura në raste studimi, ku kemi vërejtur se ky fenomen negativ pra, ‘krimi i jakave të bardha’ është i përpur shumë në vendin tonë dhe në rajon.

5.3 Mostra

Mostra është pjesë e popullacionit. Popullacioni në punim tonë është rast studimi i ‘krimit të jakave të bardha’ në Maqedoni dhe rajon.

5.4 Analiza

5.4.1 Pastrimi i parave

Trafikimi i drogës, qenieve njerëzore, armëve, kontrabanda e migrantëve, si dhe shumë vepra të tjera të krimit të organizuar, kanë për qëllim gjenerimin e të ardhurave të shumta për grupet dhe pjesëtarët e përfshirë në këto veprimtari. Pamundësia për të justifikuar këto të ardhura me burime të ligjshme hedh dyshime mbi përfituesin e tyre lidhur me veprimtaritë ku është përfshirë. Për të mos tërhequr vëmendjen e autoriteteve ligjzbatuese duke rrezikuar veten, bashkëpunëtorët, vazhdimësinë e veprimtarisë dhe sekuestrimin e të ardhurave të paligjshme, personat e përfshirë në veprimtari kriminale fitimprurëse duhet të fshehin origjinën e vërtetë të parave. E thënë thjesht, ‘paratë e pista’ duhen ‘pastruar’ për t’u përdorur lirisht. Pastrimi i parave është procesi përmes të cilit të ardhurat kriminale shndërrohen në të ardhura ‘në dukje’ të ligjshme. Ky proces varion në kompleksitet dhe sofistikim, por në thelb ka për qëllim të fshehë origjinën e të ardhurave të paligjshme, të ndryshojë formën e tyre dhe t’i zhvendosë duke tërhequr sa më pak vëmendje. Këtij procesi nuk i nënshtrohet vetëm ajo pjesë e të ardhurave të

riinvestuara në veprimtari kriminale. Pastrimi i parave është ngushtësisht i lidhur me krimin e organizuar, veçanërisht me depërtimin dhe ndikimin e shtuar në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore në vend. origjinën e të ardhurave të paligjshme, të ndryshojë formën e tyre dhe t'i zhvendosë duke tërhequr sa më pak vëmendje. Këtij procesi nuk i nënshtrohet vetëm ajo pjesë e të ardhurave të riinvestuara në veprimtari kriminale. Pastrimi i parave është ngushtësisht i lidhur me krimin e organizuar, veçanërisht me depërtimin dhe ndikimin e shtuar në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore në vend.⁶¹ Në këtë kuptim, pastrimi i parave mund të konsiderohet një indikator i fuqisë së krimit të organizuar.⁶² Rritja e fuqisë së krimit të organizuar, krahas procesit të vazhdueshëm të pastrimit të parave, nënkupton më shumë krim, të ardhura të paligjshme, korrupsion dhe pandëshkueshmëri. Faktorët që kanë favorizuar pastrimin e parave në Shqipëri lidhen me tranzicionin nga një ekonomi e kontrolluar në ekonomi tregu të ndikuar nga një nivel i lartë informaliteti dhe kriminaliteti.⁶³ Shkalla e lartë e informalitetit në vend është karakterizuar nga niveli i lartë i qarkullimit të parasë në dorë 'kesh', remitancave, evazionit fiskal, dhe tregut të zi. Në të njëjtën kohë, kanë ndikuar edhe kontrollet e dobëta doganore, si dhe niveli i ulët i deklarimit, regjistrimit dhe hipotekimit të veprimtarive ekonomike, të ardhurave dhe pasurive të patundshme. Informaliteti i lartë vështirëson jo vetëm procesin e identifikimit të të ardhurave me origjinë të paligjshme, por edhe veprimet e mëtejshme si sekues-trimi, konfiskimi dhe nxjerrja në ankand e aseteve kriminale të paregjistruara dhe hipotekuara.⁶⁴

Politikanë të korruptuar dhe grupe të organizuara kriminale kanë përvetësuar prona të caktuara, sipas zgjedhjes së tyre, përmes korruptimit të procesit të privatizimit në vend dhe pastrimit të të ardhurave të paligjshme.⁶⁵

a) Disa raste të ekzaminuara nga ZIF (SHqipëri) rreth krimit financiar - ekonomik

⁶¹ Petrunov, g. 'money laundering in bulgaria: the policy response', risk monitor 2010: 8.

⁶² Intervistë me prokuror (kod 28), qershor 2014.

⁶³ Petrunov, g. 'money laundering in bulgaria: the policy response', risk monitor 2010: 8

⁶⁴ Intervistë me prokuror (kod 22), qershor 2014.

⁶⁵ Gjoni. i 'organized Crime and national security: the albanian Case' 2004: 34

Pastrimi i parave bëhet kryesisht nëpërmjet një procesi pastrimi përmes disa fazave që ndjekin njëra-tjetrën. Në fazën e parë (placement) kush pastron paratë përpiqet të thyejë tërësinë e rregullave për të futur në zonat “e shëndetshme” (ndërmjetës të mbikëqyrur) paratë e pista. Kjo është faza më delikate, sepse ky “i ftuar i huaj”, sapo vendoset në botën e mbrojtur, rrezikon të njihet nga sensorët që gjenden tek ndërmjetësit; në fakt, ata janë të përgatitur të pikasin mospërputhjen në përmasa dhe në modalitete të parave me profilin “e pritshëm” pasuror që duhet të ketë klienti. Kush pastron paratë duhet të fshehtë origjinën e ardhurave tëpaligjshme përmes mekanizmave kërcënues, të korrupsionit apo i falsifikimit.

Në rastin e Capital Leben, ZIF ka siguruar sekuestrimin jashtë vendit të një shume më të madhe se 20.000.000 USD, të vjedhur në rrugë të paligjshme gjatë ngjarjes Parmalat. Në veçanti, i) në kryerjen e hetimeve të ndërmarra kryesisht mbi të dhënat që ka arkivii të dhënave të grumbulluara, ZIF vërejti një parregullsi financiare qëndodhi në provincën e Parmës, e që konsistoi në vendosjen e një urdhër-pagese prej 20.000.000 USD drejt Litenshtejnit; ii) pasi ZIF komunikoi me bankën që kish kryer operacionin ajo dërgoi një ROD, nga ku rezultoi se urdhër pagesa ish urdhëruar mbi një llogari rrjedhëse në emër të një shoqërieParmalat të Maltës, në favor të një shoqërie sigurimi të Litenshtejnit, me para që vinin nga kreditimi i një urdhër-pagese të mëparshëm të urdhëruar nga një shoqëri Parmalat e Vendeve të Ulëta; iii) duke u mbështetur në këto informacione, ZIF u lidh me ZIF e Litenshtejnit, që njoftoi seshuma e urdhër-pagesës ishte përdorur, me urdhër të një shoqërie investimesh tëIshujve britanikë,për blerjen e një police sigurimi për jetesën në favor të një avokati banues në Brazil; iv) me kërkesë të ZIF italiane, ZIF e Litenshtejnit kreu “ngrirjen”e policës së sigurimit për jetën, që më pas u shoqërua me sekuestrimin gjyqësor të vendosur me kërkesë të një letërporosie të Prokurorisë së Parmës.

Në rastin Nazionale Fiduciaria, ZIF ndihmoi prokurorinë duke hedhur dritë mbi një numër të caktuar veprimesh të paligjshme për shuma jashtëzakonisht të rëndësishme, gjatë vitit 2003, nga përfaqësuesit më të lartë të Unipol. Në veçanti, i) nga analiza e të dhënave të grupuaratë përcjella nga Nazionale Fiduciaria Spa, ZIF mësoi për ekzistencën e dosa operacioneve kreditimi dhe debitimi përmes urdhër-pagesave për shuma shumë të mëdha; ii) pasi iu kërkuua Nazionale Fiduciaria-s të jepte informacione lidhur me këtë, ajo bëri medije se operacionet ishin kryer në dy llogari rrjedhëse, në emër të dy përfaqësuesve, dhe konsistonin për secilin prej tyre në marrjen e një urdhër-pagese prej rreth 25.000.000 €, në blerjen dhe në shitjen e letrave me vlerë të

Antonveneto, në urdhërimin e një urdhër-pagese për rreth 28.000.000 € në favor të llogarive rrjedhëse të po këtyre personave pranë Bankës Popullore të Lodit; iii) pasi u lidh me Bankën Popullore të përdorimin e mëtejshëm të shumës së krijuar nga operacionet e mësipërme; iv) për operacionet e mësipërme janë duke kryer verifikime investiguese nga ana e Prokurorisë së Milanos.

Në rastin **Islamic Charity** ZIF dha ndihmën e saj në kryerjen e një hetimi penal në lidhje me terrorizmin ndërkombëtar. Në veçanti, i) në janar të vitit 2002, ZIF mori një ROD lidhur menjëherë me lëvizje jo të zakonshme të kryer mbi llogarinë rrjedhëse në emër të një shoqate islamike bamirësie e administruar nga një shtetas jordanëz, një kuvaitian dhe një izraelit; ii) nga kërkimet e bëra nga ZIF doli se llogaria rrjedhëse në emër të shoqatës kish marrë një numër të madh urdhër-pagesash, për një shumë mes 5.000 € dhe 10.000 €, për të cilat ishin urdhëruar urdhër-pagesa për një shumë më të madhe në favor të shoqatave islamike të bamirësisë, kombëtare dhe të huaja; iii) ROD dhe analizat e bëra lidhur me to iu përcollën më pas Autoritetit Gjyqësor, që kish nisur nga ana e vet një hetim penal mbi këtë fakt; iv) ndërkohë, ZIF mori një kërkesë nga ana e ZIF izraelite, lidhur me çdo informacion të dobishëm mbi administratorët e shoqatës islamike të raportuar; v) meqenëse ekzistonte një hetim penal, ZIF krijoi lidhje mes Prokurorisë kombëtare dhe ZIF izraelite, që u pasua me një shkëmbim letërpërcororishmes Autoriteteve Gjyqësore dhe izraelite mbi këtë fakt. Shqipëria ka bërë pohime të përgjithshme lidhur me mashtrimet në fushën e doganave dhe evazionit fiskal dhe ka raportuar të dhëna statistikore të cilat gjithësesi nuk mund të shërbejnë për një analizë meqenëse shifrat ndryshojnë së tepërmi në varësi të burimit të tyre si dhe kanë përfshirë edhe një gamë të gjërë edhe të krimeve të tjera. Në fushën e doganave Ministria e Brendshme ka raportuar shifrën e 120 veprave penale nga të cilat 33 në lidhje me shkeljen e ligjeve tatimore, ndërkohë që Prokuroria e Përgjithshme e cila zotëron statistika më të besueshme për 427 raste.

b) Republika e Maqedonisë dhe krimi ekonomik

Është raportuar se 114 raste të evazionit fiskal janë evidentuar në vendin tonë, me 178 autorë dhe përgjithshishtë kuptohet se mashtrimi me TVSH-në dhe kontrabanda vijnë të mbeten një problem kyq në veçanti kontrabanda e cigareve, alkoholit, tekstileve, kompjuterëve, telefonave celurë, dhe produkteve ushqimeve. Krimi ekonomik është formë e krimit që bën pjesë në veprën penale e cila dëmton rëndë ekonominë apo pasurinë qoftë të një individ apo edhe të shoqërisë. Shpërlarja e parave është formë e krimit të organizuar, aktivitet me anë të së cilit paarët e fituara nga aktiviteti ilegal kriminal (trafik i drgës, i armëve, i prostitucionit klandestinëve, kontrabandimit me mallra dhe njerëz, terrorizmëm etj). T'i pastroje, t'i lajë duke u plasuar në veprimtari legale apo duke i depozituar në rrjedha legale ekonomike e financiare. Për tëqarkulluar paratë e akumuluar nga format e ndryshme të kriminalitetit kryejësit e veprave të tilla penale, synojnë t'i paraqesin ato si ligjshme duke i investuar ato si në vijim:

- a) *Biznese apo ndërmarrje private;*
- b) *Blerje të pasurive të palujtshme apo partneritete përmes aksioneve të dyshimta*
- c) *Ndërtime të shtëpive, lokaleve afariste, apartamente luksozë për banim e ndërtime të tjera, kompanive për shitjen e derivative të naftës.*

Shpërlarja e parave kërkon zhvillimin ekonomik sundimin e ligjit, rendin dhe sigurinë publike, stabilitetin makroekonomik dhe kontribon në krijimin e një klime të përshtatshme për krim të organizuar, korrupsion e terrorizëm. Maqedonia dhe oas tre viteve që kur është shtet i pavarur mund ta pranojmë zyrtarisht se papuniësinë e kemi rreth 43% .sipas dokumenteve të Bankës Botërore niveli i varfërisë së përgjithshme është 32% kurse varfëria e skajshme ka mbërritur në 18%. Krimi financiar në Republikën e Maqedonisë është në rritje në një shkallë alarmanet dhe globalizuese si gjeografikisht astu edhe në larmi për çka duhet thirrje për veprime urgjente globale. Andaj, kuptimi i thëllë i krimit financiar dhe dinamikave të tij në vend është një hap i parë i domosdoshëm për hartimin e një strategjie efektive të reformave qëia përcakton vendit një rrugë të re drejt integritetit më të madh të qeverisë dhe që rezulton në zhvillim ekonomik.

PJESA E GJASHTË

6.1 Konkluzë

Në përmasat e krimit ekonomik -financiar, mund të konkludojmë se padyshim ndikon edhe mospërshtatja me ekonominë e tregut si dhe dëshira për pasurim të shpejtë dhe me rrezik më të vogël, të cilat paraqesin motivin për këtë veprimtari të fshehtë, pra, në thelb, bëhet fjalë për faktorë të natyrës ekonomike. Përveç faktorëve ekonomikë, disa njohës të rrethanave ekonomike në Maqedoni, si shkaktarë të paraqitjes së krimit ekonomik përveç tjerash konsiderojnë edhe faktorët psikologjikë, si për shembull: humbjen e besimit tek shteti dhe masat ekonomike të tij, mentalitetin e popullit dhe mospajtimin e tij me objektivat dhe masat e politikës ekonomike, pranimin e shkallës së lartë të rrezikut në aktivitete afariste etj. Zhvillimit dhe përhapjes së krimit ekonomik në Maqedoni përveç faktorëve që u përmendën më lartë i kontribuojnë edhe dukuri të tjera si: shkalla e lartë e papunësisë, rënia e prodhimit dhe standardit jetësor, humbja e besimit në sistemin bankar, numri i madh i personave të zhvendosur e të dëbuar që janë pa punë, mos-efikasiteti i institucioneve, politikat relativisht të buta të ndëshkimeve, procesi i ngadalshëm i privatizimit etj.

Po ashtu, zgjerimit të krimit ekonomik i japin mbështetje edhe kushtet e pabarabarta të afarizmit për shkak të mungesës së dispozitave ligjore, por edhe moszbatimi me konsekuencë i dispozitave ligjore ekzistuese. Krimi ekonomik-financiar nuk është problem vetëm për shtetet e Ballkanit por është një problem i madh dhe mund të paraqes pengesë për stabilitetin në rajon. Krimi ekonomik, në shumë mënyra është një çështjenë zhvillim në rajon, që reflekton mungesën e mbrojtjes adekuate të drejtave tëpronës, mungesën e mundësive ekonomike vendore, mungesën e edukimit të popullatës dhe rindërtimit të institucioneve të reja. Kapaciteti Maqedonisë për të hetuar dhe ndjekur krimin ekonomik mbetet i limituar. Ekspertët përçeshtje ekonomike, thonëse krimi financiar, i cili, sipas statistikave të Policisë së Maqedonisë, është mjaft i pranishëm, do të mund të veprohet përmes ushtrimit të shtetit ligjor dhe fillimit të proceseve demokratike në përgjithësi.

Po ashtu erdhëm në konkludim se Erdhëm në konkludim se të gjitha hipotezat e punimit janë aporovuar *Pagat e ulëta në sektorin publik ndikojnë që në Republikën e Maqedonisë të jetë pjesëmarrëse Kriminaliteti i “jakave të bardha”. Dëshira për pasurim të shpejtë të njerëzve është faktor që ndikon në paraqitjen e këtij fenomeni. Kriminaliteti është kategori penale – juridike. Krimi ekonomik financiar është pengesë për zhvillim në vendin tonë.*

6.2 Rekomandime

Ekzistojnë shumë pak punimë të kësaj sfere analizën e fenomenit negativ të Krimin të Jakave të bardha. Në luftimin dhe parandalimin e formave të krimt të organizuar janë në zbatim masa, mjete dhe metoda efikase, sidomos në vendet e zhvilluara dhe me standart të lartë të organizimit dhe përgatitjes kadrovike. Në këtë drejtim rol të rëndësishëm kanë edhe shërbimet speciale të policisë dhe ndjekjes së krimin të organizuar, të cilat shërbime disponojnë informacione dhe të dhëna të tjera të llojllojshme dhe evidenca kriminale të sistemuara. Si masa apo mjete përdoren edhe bastisjet e fshehta të lokaleve apo banesave ku dyshohet se gjenden prova dhe të dhëna të tjera mbi krimin e organizuar dhe kryesit e tij. Natyrisht se këto veprime ndërmerren me lejen e prokurorive dhe gjykatave në bazë të urdhërave të dhëna. Si masë dhe metodë mjaft efikase kundër krimin të organizuar konsiderohet edhe pengimi i larjes së parave, të cilat janë fituar në mënyrë ilegale, përmes kryerjes së formave të ndryshme të krimin të organizuar. Ky pengim mund të arrihet përmes vërtetimit të origjinës së parave, bllokimit të tyre, konfiskimit apo sekuestrimit nga organet. Në fund mund të rekomandojmë se luftimi i kriminalitetit në përgjithësi dhe krimin të organizuar në veçanti është sfidë politike dhe më pas sfidë për sistemin e sigurisë, atë të drejtësisë e nënsistemet e tjera në shtet. Gjithnjë e më tepër po vërtetohet se pa vullnet politik nacional dhe dakordim të nevojshëm politik ndërkombëtar nuk ka shtet ligjor dhe siguri të qëndrueshme.

6.3 Përfundimi

Para se të nxjerrim konkluzionet lidhur me veprimet që duhet ndërmarrë për luftimin e krimit ekonomik-financiar në Maqedoni është shumë me rëndësiqë të përmendim edhe njëherë faktorët kryesor që kanë ndikuar në shfaqjen, shtrirjen dhe zhvillimin e krimit ekonomik-financiar në Maqedoni, e që ata janë faktorë të cilët gjenezën ekanë nga sistemi i kaluar socialist, ngapapunësia e madhe që mbretëron, varfëria e popullatës, periudha transite e cila ende po vazhdon etj. Nga ana tjetër, nuk ekziston qasje e harmonizuar për parandalimin dhe pengimin e krimit ekonomik-financiar, pushtet-mbajtësit ende nuk gëzojnë nivel të kënaqshëm të mirëbesimit tek publiku, shoqëria civile ende është në fazën e zhvillimit të saj, vetëdija e qytetarëve për drejtat dhe obligimet e tyre është në nivel shumë të ulët, roli i medieve është ende shumë i vogël në sensibilizimin e publikut për pasojat që shkaktojnë krimet etj jo vetëm për qytetarin por edhe për sigurinë e përgjithshme në Maqedoni. Përdorimi i këtij termi nuk buron thjesht nga natyra libeske e të lexuarit të ngjarjeve, por nga përvoja e hidhur reale, e cila shkaktoi midis popullit shqiptar dhe klikës qeverisëse të Sali Berishës situata herë ulëritëse dhe herë të heshtura "në gjendjen e tyre kimikisht të pastër". Si e ka etiketuar që më 1943 krimin ekonomik dhe financiar kriminologu i njohur amerikan, Edëin Sutherland? Prej disa vitesh rresht, në rrethet e juristëve dhe punonjësve të shtypit të vendit tonë është përmendur ndonjëherë edhe termi i mësipërm. Më së shumti për të ekspozuar bagazhin leksikor dhe më pak për të përkufizuar përgjegjësinë e klasës sonë politike në adresë të shpërblimeve, shpërdorimit të pushtetit, ryshfeteve, të praktikave ekonomike të pandershme, apo edhe pastrimit të parave. Gjithçka është thënë ashtu, si rastësisht dhe me zë të ulët, pa u thelluar seriozisht asnjëherë te rrugët e të luftuarit të kësaj dukurie të rrezikshme për fatet e zhvillimit demokratik, të forcimit të shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Gradualisht, një formë e tillë (figurative, sigurisht) e këtij lloji të veçantë të kriminalitetit nuk u shqiptua më, ndoshta sepse sa vinte e bëhej më shqetësues krimi i atyre që cilësoheshin "flokëpalarë" apo "zverkpalarë", që u përhap dhe demonstrohej kërcënueshëm çdo ditë, si brenda vendit, ashtu edhe jashtë tij. Gjithashtu, vëmendja tërhiqej edhe nga krimi shtetëror në dëm të sigurisë së personit dhe ruajtjes së rendit publik, çka fatkeqësisht nxiti keqkuptimet brenda popullatës, duke u shoqëruar me trajtat e një lufte të të gjithëve kundër të gjithëve. Në këtë kuadër, korrupsioni po zgjerohej, por në dallim nga i pari, ai nuk po ndëshkohej. Fjala

"korrupsion" u shndërrua në një klishe të thjeshtë dhe opinionin ynë u mësua me këtë realitet. Madje, në përgjithësi, vështirë të gjendej mes nesh ndokush që të shpresonte dhe të besonte, se ndonjëherë do të kapeshin në rrjetën e shtetit "peshqit e mëdhenj". Megjithatë, qysh në fillim të viteve '90, kur gjithnjë e më tepër po shtoheshin edhe për shqiptarët mundësitë dhe kanalet e informimit, shumëkush e mësoi që mjaft vende të Europës u tronditën nga skandale korrupsioni në shkallë të gjerë, që vunë seriozisht në pikëpyetje stabilitetin e institucioneve demokratike dhe funksionimin e ekonomisë së tregut. Prandaj, organizmat ndërkombëtare dhe rajonale u vunë në pararojë për t'i dhënë luftës kundër korrupsionit një karakter ndërdisiplinor dhe për ta vënë atë mbi baza jo më rekomanduese, por plotësisht ligjore.

Mjafton të përmendim këtu, se ishin Plan-Veprimi i miratuar nga samiti i Strasburgut më tetor 1997 dhe 20 Parimet udhëheqëse në këtë fushë, mbi të cilat u përpunua, krahas një sërë instrumentesh juridike ndërkombëtare obliguese për të gjitha Shtetet Anëtare të këtyre organizmave, edhe "Konventa Penale Europiane Kundër Korrupsionit", që u hap për nënshkrim më janar të 1999-ës. Dhe, Shqipëria, siç është treguar shpeshherë e gatshme ndër të parat shtete të vërë formalisht firmën mbi dokumente madhore të tilla, kështu veproi edhe në këtë rast, për të dhënë një shenjë të vullnetit të vet politik në luftën kundër korrupsionit. Sikurse nënshkroi pak më vonë edhe marrëveshjen GRECO, si për t'u paraqitur e gatshme që të marrë pjesë në atë që njihet si "Grupi i shteteve kundër Korrupsionit". Por, ndërsa detyrimet ndërkombëtarisht të Shqipërisë në këtë lëmë, që vetë shteti ynë i merrte përsipër me një ngazëllim në dukje, sa vinte e shtoheshin pa ndërprerje, ky argument politik u përdor fuqishëm nga opozita e atëhershme në seancat plenare parlamentare të këtushme dhe në kancelaritë europa-atlantike, për ta marrë ajo pushtetin në vitin 2005, duke kafshuar pastaj gjuhën ndaj gjithçkaje që kishte deklaruar më parë dhe për të servirur brenda vendit haptazi 'de facto' dhe fshehurazi 'de jure' korrupsionin qeveritar në një platformë të drejtimit shtetëror dhe zhvillimit ekonomik. Ishin këto tetë vitet e fundit që shkaktuan midis popullit dhe klikës qeverisëse të Sali Berishës një situatë herë ulëritëse dhe herë të heshtur urrejtjeje "në gjendjen e tyre kimikisht të pastër".

Prandaj, nga më të shumtët nuk mund të mos pritej gremisja e kësaj qeverisjeje humnerës, në prag të së cilës po e çonte vendosmërisht popullin shqiptar dhe gjithë ekonominë bashkë me kulturën politike të tij. Nuk mund të mos pritej, njëherazi, që me votimin e 23 qershorit historik për të ardhmen e Shqipërisë opozita e majtë të mos fitonte fuqishëm, siç e ka cilësuar Ambasadori i SHBA në Tiranë, Arvizu, ndërrimin e pushtetit.

Ndërkohë që ky cilësim nënkupton, gjithashtu, edhe një përgjegjësi të fuqishme të koalicionit fitues, për t'ia lënë së shkuarës deklaratat eufemike dhe, krahas reformimit të jetës institucionale të shtetit, të luftojë dhe zhbëjë praktikën e metodat korruptive të lëna si trashëgim, duke e bërë më së fundmi popullin shqiptar të marrë frymë lehtësisht tani dhe në të ardhmen e tij. Ndryshe, ai nuk do të gjente kurrë qetësi dhe vendi asnjëherë stabilitet, sepse ato praktika dhe metoda, pa u ndëshkuar rast pas rasti, penalisht dhe individualisht, rrezikojnë të përsëriten dhe të bëhen pengesë për zhvillimet e premtuara. Në këtë vështrim, që në hapat e parë të qeverisjes së re, vëmendja e saj vlerësohet që të përqendrohet intensivisht te "zbërthimi" i krimit të jakave të bardha, një term ky që nuk ka pasur dhe nuk ka një karakter libreshk. Përkundrazi, një përvojë të hidhur reale të shumë kohëve me radhë në plot e plot vende të botës, luftimi i së cilës, qoftë edhe në mënyrë jopërfundimtare, ka imponuar ndryshime të vazhdueshme në të mirë të njerëzimit. Ishte kriminologu i njohur amerikan, Edëin Sutherland ai që qysh në vitin 1943 e etiketoi në mënyrë figurative krimin ekonomik e financiar të kryer nga ndërmarrjet e mëdha si "Ëhite collar crime", duke nënvizuar atëherë dallimin që ekziston midis përmasave të këtyre praktikave me kosto shoqërore të lartë dhe mungesës së kuptimit shoqëror për rolin e tyre, që ndonjëherë gjeneron sanksione minimale. Përballë këtij mosdënimi, Sutherland shtronte pyetjen: "Krimi me jaka të bardha, a është krim?".

Me gjithë praninë e dispozitave penale për ndëshkimin e veprimtarive që cenojnë konkurrencën, mashtrimin mbi mallrat, dhunën e së drejtës së shoqërive ekonomiko-tregtare dhe butësinë e reagimit shoqëror ndaj tyre, sipas tij shënonte një mohim penal sistematik. Kriminologu amerikan kujtohet, gjithashtu, si ndër të parët që theksoi se deri në çfarë pike është përherë problematik vlerësimi shoqëror i akteve të paligjshme që kryejnë mbajtësit e pushtetit. Në atmosferën tonë aktuale, asgjë nuk mund të pengojë që gjendje të caktuara, të krahasueshme në mjaft drejtime, të përkufizohen me fjalën "korrupsion". Le të përmendim këtu çështjet e "Rrugës së Kombit", të "Gërdecit", të "Albpetrolit", "Armos", të trafikeve ndërkombëtare të paligjshme të armatimeve nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes etj., etj. Të gjitha këto kanë mbetur deri tani dosje të mbyllura me justifikime të ndryshme: për mungesë provash, për produkte të shpifjeve, për dënime të rangjeve të ulëta të përgjegjësisë etj., etj.

Mirëpo ajo që është vënë re fare qartë për secilën prej tyre është fakti që instancat publike përkatëse të vëna nën thundrën e Pushtetit Ekzekutiv i minimizuan ekstremisht efektet e dëmshme që u përcollën nëpërmjet fakteve të këtyre dosjeve. Tani është koha që t

ranskriptimi i ngjarjeve që përmbajnë këto çështje dhe i autorëve të vërtetë që i kanë shkaktuar ato të mbështetet në disa tipare kryesore, si: seleksionimi i fakteve domethënëse dhe balancimi i tyre, duke u njohur rëndësinë e caktuar në funksion të paligjshmërisë, të viktimave, të dëmeve etj; hetimi dhe paditja nëpërmjet lidhjeve shkakësore, ku është angazhuar përgjegjësia e autorëve të përfolur mjaft deri më sot; dhënia ndaj tyre e dënimeve të përligjura etj., etj.

Sidoqofshin ato që pritet të ndodhin së shpejti, këto radhë u shkruan vetëm si një parathënie, për të kujtuar gjithashtu që mbështetja në këtë luftë e qeverisjes së re nga faktori ndërkombëtar është deklaruar mëse një herë dhe me plot gojën, veç të tjerash, mbi mundësitë e kapaciteteve tekno-logjike, mundësive të komunikimit dhe burimet e mëdha njerëzore që disponon ky faktor, te përvoja frytdhënëse e sagës së gjatë amerikane në luftën e një natyre të tillë dhe në neutralizimin e korrupsionit strukturor të deritashëm.

6.4 Bibliografia

1. Clarke, R. V. G. (1997). *Situational Crime Prevention: Successful Case Studies* (2 ed.). Harroë and Heston. ISBN 9780911577389
2. Dr. Latifi Vesel, *Politika Kriminale*, Prishtinë, 2011
3. Dr. Mersida Suçevska, *Baza e kriminalitetit ekonomik*, Prishtinë, 2006, FSK/S – 07/06
4. Dr. Salihu, *E drejta Penale – pjesa e përgjithshme*, Prishtinë, 2008
5. Dr. Zvekiç, *Zrtve Kriminala u zemljama u tranziciju*, Beograd, 2011
6. Dr.Ragip Halili; “Kriminologjia” Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë 2000
7. Dr.Slobodanka Konstantinović i Dr. Vesna Nikolić-Ristavonić; “Kriminologjia” Studenstki kulturni centar Niš, Niš 1997
8. Dr.Željko Horvatić, Dr.Zvonimir Šqeparevë i drugi: “ Kazнено Pravo – Posebni Dio”CIP-
9. *Katalogizacija u publikaciji Nac ionalna i sveučilišna knjižica*, Zagreb 1999
10. M. sc Driton Muharemi, Doc.Dr Nexhat Korajlic, *Kriminalistika*, Prishtinë, 2009
11. Miço Bošković; “Kriminalis tička metodika I”, Policiska Akade mija, Beograd 1998
12. N.Serzentiq e A.Stajiq “E drejta Penale” Pjesa e posaçme, Prishtinë 1981
13. O'Grady, Ėilliam (2011). *Crime in Canadian Context: Debates and Controversies* (2 ed.). Oxford University Press. ISBN 9780195433784 Retrieved 1 June 2012.
14. Prof. Dr Rexhep Gashi, *Krimi i organizuar (ligjerata të autorizuara)*, Prishtinë, 2014
15. Reid, Sue Titus, *Crime and Criminolohy*, Ninth Edition, Boston 2000,
16. *Revistë Shkencore Shoqërorë, Vizione* (ISSN 1409-8962, UDC 316,33,32) , Shkup, 2011, Vëllimi 16.
17. Vesel Latifi, *Kriminalistika*, Prishtinë, 2011
18. Ėhite Collar *Criminal Defence Guide*, Laë Offices of Randy Collins. Retrieved 2016-12-23.
19. Арнаудовски, Љупчо „Криминологија“, Штип : 2-ри Август С, 2007
20. Виолета Чачева, *Корупцијата во јавната администрација*, МРКК, бр. 3/2006,
21. Гоце Џуклески, Светлана Николоска, *Економска криминалистика*, Скопје, 2007,
22. Гоце Џуклески, Светлана Николоска, *Економска криминалистика 2* , Скопје, 2008

23. Kaјзер, Гинтер „криминологија“, Александрија, Скопје, 1996
24. Kaјзер, Гинтер „криминологија 2“, Александрија, Скопје, 1998,
25. Камбовски, Др. Владо „организиран криминал“ правен факултет „Јустинијан Први“, Скопје
26. Камбовски, Др. Владо „организиран криминал“ правен факултет „Јустинијан Први“, Скопје
27. Мајк Мегваер, Род Морган, Роберт Рајнер, „Оксфордски прирачник за криминологија“ Нампрес, Скопје 2010
28. Мајк Мегваер, Род Морган, Роберт Рајнер, „Оксфордски прирачник за криминологија“ Нампрес, Скопје 2015
29. Dr. Mersida Suçeska, Bazat e kriminalitetit ekonomik, Prishtinë, FSK/S – 07/06, 2006
30. Ross Edëard A, Sin and Society, 1907
31. S. Pihler, Drejt konceptit bashkëkohor të kriminalitetit ekonomik, Problemet aktuale të shkatërrimit të kriminalitetit, Instituti për hulumtime sociologjike dhe kriminologjike, Beograd, 1993, f.35-38 Leksikoni kriminologjik
32. N.Serzentiq e A.Stajiq “ E d rejta Penale” Pjesa e posaçme, Prishtinë 1981
33. Komentar Kriv iчnog Zakona SFRJ “ Savremena Ad min istracija” Beograd, 1982
34. Dr.Se lman Se lmana j “Fa ktorët limitues që ndikojnë në ngecjen e sendertimit sektorit prinar në Kosovë” Hulumtim i botuar nga REINVSET Nr.2 ne Prishtinë
35. Dr.Slobodanka Konstantinović i Dr. Vesna Nikolić-Ristavonić; “Kriminologija” Studenstki kulturni centar Niš, Niš 1997
36. Ma.Sc.Lirim Dervisholli, “Krimi Financiar – Pengesë për Zhvillim Ekonomiko-Social në Vende të Evropës Juglindore”, Prishtinë, 2010
37. Mirza Smaiq, Krimi i organizuar në Bosnje dhe Hercegovinë, Sarajevë, Fakulteti i shkencave Politike-Universiteti i Sarajevës
38. Borisllav Petroviq & Bojan Dobovshek, Rrjeti i krimit të organizuar, Sarajevë, Fakulteti Juridik , Universiteti i Sarajevës, 2007
39. Mr.sc Fatos Haziri, Krimi i organizuar si fenomen kërcënues për sigurinë publike dhe sundimin e rendit dhe ligjit në Republikën e Kosovës
40. Elmedin Muratbegoviq, Parandalimi i kriminalitetit (compendium of crime prevention and crime control), Sarajevë / Prishtinë, Prill, 2007

41. Anzalone, Charles (28 April 1991). "White-Collar Crime Has Become Priority of Law Enforcement". Buffalo News.
 42. Anderson, Jenny (20 January 2005). "S.E.C. Settles ImClone Insider Trading Case". New York Times. Retrieved 1 June 2012.
-
- ✓ *Rekomandimi i Këshillit të Evropës R (81) 12 i vitit 1981 , mbi Krimin Ekonomik (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 25 qershor 1981) rendit 16 vepra penale specifike dhe jo specifike të cilat konsiderohen krime ekonomike*
 - ✓ *Министерство за финансии (2005) „Национална стратегија за борба против перење на пари и финансирање на тероризам“, Скопје*
 - ✓ *Законот за спречување на перење пари и други приноси од казниво Дело и финансирање на тероризам (Службен весник број 04/08, 57/10, 35/11, 44/2012 и 43/14)*
 - ✓ *Petrinov, g. 'money laundering in bulgaria: the policy response', risk monitor 2010*
 - ✓ *Petrinov, g. 'money laundering in bulgaria: the policy response', risk monitor 2010: 8*
 - ✓ *Inrervistë me prokuror (kod 22), qershor 2014.*

